

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5757  
E premte, 19 prill 2019  
çmimi 0.40 €

246 kërkesa për  
legalizimin e armëve  
marrin pëlqimin e  
MPB-së | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



FLET PËR "EPOKËN E RE", RAMË VATAJ | FAQE 4-5

## Politikanët e padijshëm më nxitën t'i rikthehem politikës



Kryetari i ri i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Therandë, Ramë Vataj, ka treguar arsyet e rikthimit në politikë pas pesë vjetësh. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se marrja e politikanëve të padijshëm me çështje akademike ka qenë arsyeja

kryesore pse ka vendosur sërish të merret me politikë. Sipas tij, nuk duhet lejuar që politikanët analfabetë të vendosin për rektorë, profesorë apo për pozita të larta në universitetet publike. Vataj ka shprehur optimizëm se do ta fuqizojë PDK-në në këtë komunë me aderime të reja dhe me

kthimin e aktivistëve dhe të anëtarëve të tjerë në 'shtëpinë e vjetër'. Ai ka thënë se PDK-ja në përfundim të procesit të zgjedhjeve të brendshme do të dalë më e fortë dhe më e konsoliduar se të gjitha partitë e tjera. Vataj ka pohuar se zgjedhjet në nivel kombëtar janë afër

## Qeveria ndan rreth 500 mijë euro për zgjedhjet në veri | FAQE 3



Organizimi dhe mbajtja e zgjedhjeve të jashtëzakonshme më 19 maj në veri të vendit do t'i kushtojë buxhetit të Kosovës rreth 500 mijë euro. Vendimi për ndarjen e këtyre mjeteve është marrë të enjten në mbledhjen e

Qeverisë së Kosovës. Kabineti qeveritar ka ndarë 471 484 euro për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) si dhe 18 618 mijë për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)



Kosova bëhet  
me program  
që mundëson  
reagim të shpejtë  
në rastet e  
infarkteve akute | FAQE 7

### AKTUALE

**SIGURIMI I  
USHQIMIT ËSHTË  
PRIORITET NDËR  
PRIORITETE** | F. 12

Shkruan: Prof. dr. Imer  
R. RUSINOVCI



**'REPORTERËT PA KUFIJ':  
KOSOVA NË VENDIN E 75-të  
PËR LIRINË E SHTYPI** | F. 5

**VESELI BËN THIRRJE PËR  
FORCIM TË LUFTËS KUNDËR  
KORRUPSIONIT** | F. 5



### EKONOMI

**BERZH-i DO TA VAZHDOJË  
MBËSHTETJEN E PROJEKTEVE  
PËR KOSOVËN** | F. 9

**MINISTRI SHALA: PRIORITET  
IMI ËSHTË PËRKRAHJA E  
PRODHUESVE** | F. 8

### KULTURË

**MINISTRI GASHI:  
TË HARTOHET NJË LIGJ  
QË PËRKON ME KËRKESAT  
E TË RINJVE** | F. 18

### SPORT

**GASHI: TA HARROJMË  
FITOREN ME 'NIKLIN',  
FOKUSI TE FLAMURTARI** | 8

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Meta: Autorët e krimeve ndaj medias të vihen para drejtësisë



Tiranë, 18 prill - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka reaguar të enjten për raportin e organizatës botërore të gazetarëve "Reporterët pa Kufij", i cili e rendit Shqipërinë në vendet ku klima e lirisë së medievet ka pësuar rënie.

Presidenti Meta shprehet se "zbritja me 7 vende në Indeksin Botëror të Lirisë së Medias dhe paralajmërimi serioz i këtij raporti, se 'ruga e Shqipërisë për në Bashkimin Evropian është e gjatë', është një kampion e fortë alarmi që duhet të na zgjojë të gjithëve". Kreu i shtetit u bënë apel institu-

cioneve t'i vendosin para drejtësisë autorët e krimeve ndaj përfaqësuesve të medias. "Apeloj me forcë që autorët e krimeve ndaj përfaqësuesve të medias të vihen menjëherë para drejtësisë dhe t'i jepet fund shantazhit, intimidimit apo çdo lloj tjetër presioni ndaj tyre. Shpreh solidaritet të plotë me gazetarët e cenuar në misionin e tyre në shërbim të lirisë, të qytetarëve dhe në interes të konsolidimit të të gjithë sistemit tonë demokratik", ka thënë presidenti Meta. "Me shqetësim të thellë përcolla sot konkluzionet e organizatës

botërore të gazetarëve 'Reporterët pa Kufij', për regresin e Shqipërisë në raport me lirinë e medias. Zbritja me 7 vende në Indeksin Botëror të Lirisë së Medias dhe paralajmërimi serioz i këtij raporti, se 'ruga e Shqipërisë për në Bashkimin Evropian është e gjatë, është një kampion e fortë alarmi që duhet të na zgjojë të gjithëve. Angazhimi i institucioneve dhe i shoqërisë në përkrahje të lirisë së të shprehurit është tregues për demokracinë, qeverisjen e mirë dhe përgjegjësinë publike në vend", ka thënë presidenti Meta.

## 'Reporterët pa Kufij': Kosova në vendin e 75-të për lirinë e shtypit

Në raportin më të ri të Organizatës "Reporterët pa Kufij" Kosova është renditur në vendin e 75-të në botë sa i përket lirisë së shtypit, mirëpo aty konkludohet se peizazhi mediatik në Kosovë, të paktën në shikim të parë, është relativisht pluralist dhe shumë media kanë pronarë pa lidhje të drejtpërdrejta politike, që rezultojnë në politika dhe mendime më të ndryshme editoriale

PRISHTINË, 18 PRILL - Organizata "Reporterët pa Kufij" në raportin më të ri e ka renditur Kosovën në vendin e 75-të në botë sa i përket lirisë së shtypit. Sipas kësaj organizate, situata politike në Kosovë është bërë gjithnjë më e tensionuar dhe e paqëndrueshme si pasojë përafritimit të Serbisë fqinje me Bashkimin Evropian, që e la Qeverinë e Kosovës në izolim diplomatik. Mungesa e transparencës së qeverisë për çështjet e raporteve me Evropën ka ngjallur reagime të fuqishme nga opinioni dhe gazetarët, thuhet në raport. Më tutje, aty theksohet se media të caktuara kanë kritikuar politikat nacionaliste të presidentit

Hashim Thaçi dhe Partisë Demokratike të Kosovës. Qeveria, në anën tjetër, thekson raportin, ka akuzuar gazetarët se janë "tradhtarë" ose "simpatizantë të serbëve".

Sa iu përket gazetarëve të komuniteteve të tjera, raporti thekson se ndarjet etnike në Kosovë janë burim shumë shqetësues për gazetarët e komunitetit serb. Mediat në gjuhën serbe, sipas raportit, janë shpesh objektiva të sulmeve verbale, ngacmimeve kibernetike dhe fushatave nga mediat pro-qeveritare, transmeton "Rel". Sidoqoftë, raporti konkludon se peizazhi mediatik në Kosovë, të paktën në shikim të parë, është relativisht pluralist



dhe shumë media kanë pronarë pa lidhje të drejtpërdrejta politike, që rezultojnë në politika dhe mendime më të ndryshme editoriale.

Prej vendeve të rajonit Mali i Zi ka renditjen më të ulët për Lirinë e Shtypit, pasi organizata e ka renditur në vendin e 104. Vendet e tjera të rajonit kanë këtë

renditje: Bosnjë dhe Hercegovina në vendin e 63-të, Kroacia në të 64-tin, Serbia në të 90-in dhe Shqipëria në vendin e 82-të. Listës së 180 vendeve i prinë Norvegjia, ndërkaq i fundit në listë është Turkmenistani. Indeksi botëror i lirisë së shtypit 2019, i përpiluar nga "Reporterët pa Kufij" (RSF), tregon se si në

nivel botëror urrejtja ndaj gazetarëve ka degjeneruar në dhunë, duke kontribuar në rritjen e frikës. Sipas raportit, numri i vendeve që konsiderohen të sigurt, ku gazetarët mund të punojnë në siguri të plotë, vazhdon të bjerë, ndërsa regjimet autoritare vazhdojnë ta forcojnë kontrollin e tyre në media.

## PD-LSI bëhen bashkë për rrëzimin e qeverisë

TIRANË, 18 PRILL - Pas mbledhjes së Kryesisë së LSI-së, zëvendëskryetari Luan Rama bëri me dije edhe vendimet e marra në këtë takim. Ai njoftoi se grupi ka vendosur që të finalizohet një marrëveshje me PD-në dhe frontin opozitar për garantimin e zgjedhjeve të lira. Luan Rama deklaroi se e vetnja zgjedhje për situatën politike është një qeveri transitore. "Shqipëria është një shtet i kapur, një shtet i kapur nga strukturat kriminale që kanë imponuar vullnetin e tyre në zgjedhjet që kanë prodhuar mazhorancën që është në

shërbim të krimit dhe mbi bazën e këtij realiteti. Aksioni politik i LSI-së, i inkuadruar në tërësinë e veprimit politik, qytetar të opozitës, do të vazhdojë me vendosmëri për të mos lejuar që në këtë vend të ketë më zgjedhje farsë, për të mos lejuar që në këtë vend të ketë më zgjedhje që komandohen dhe blihen nga grupet kriminale, për ta zgjedhur pushtetin dhe qeverinë që u shërben atyre", ka thënë ai. "Në këtë kontekst, kryesia vendosi të mandatojë kryetaren e Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe sekretarin e saj të përgjithshëm,

që ta finalizojnë marrëveshjen e bashkëpunimit me Partinë Demokratike dhe të gjithë frontin opozitar për garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, për të garantuar jo vetëm mbrojtjen e interesit publik dhe aksionin opozitar, përfshirë këtu edhe detyrat e qeverisë transitore, në mënyrë të veçantë duke specifikuar detyrat e saj dhe platformën për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Të zgjedhin në liri të plotë dhe jo siç kanë zgjedhur në zgjedhjet e vitit 2017, kur vota e tyre u ble, u kriminalizua për të prodhuar



këtë qeverisje, këtë mazhorancë që është bërë një me krimin dhe që ka krijuar jo vetëm kosto të mëdha për imazhin e Shqipërisë

por, mbi të gjitha, ka vënë në risk interesat kombëtare të integritetit evropian të Shqipërisë", deklaroi Luan Rama.

Është mbajtur mbledhja e radhës e Qeverisë së Republikës së Kosovës

## Qeveria ndan rreth 500 mijë euro për zgjedhjet në veri

Organizimi dhe mbajtja e zgjedhjeve të jashtëzakonshme më 19 maj në veri të vendit do t'i kushtojë buxhetit të Kosovës rreth 500 mijë euro. Vendimi për ndarjen e këtyre mjeteve është marrë të enjten në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës. Kabineti qeveritar ka ndarë 471 484 euro për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) si dhe 18 618 mijë për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP). Po ashtu, Qeveria e Kosovës ka ndarë 20 000 euro për rindërtimin e katedrales Notre Dame në Paris



**EPOKA  
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 18 PRILL - Qeveria e Kosovës të enjten ka ndarë rreth gjysmë milioni euro për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetarë të katër komunave në veri të vendit. Për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor të 19 majit në Mitrovicën e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan kabineti qeveritar i ka ndarë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) 471 484 euro, ndërsa Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia 18 618 euro. Gjithashtu, në shenjë solidariteti, Qeveria e Republikës së

Kosovës ka ndarë 20 000 euro për rindërtimin e katedrales Notre Dame në Paris.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se kjo shumë ka për qëllim shprehjen e solidaritetit dhe përkrahjes nga ana e Kosovës për rindërtimin e katedrales Notre Dame në Paris. Haradinaj ka propozuar që këto mjete të ndahen nga kategoria e shpenzimeve rezervë. Po në këtë mbledhje qeveria ka miratuar nismën për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për bashkëpunim në mbështetjen e themelimit të

Njësisë Qendrore për Mbështetjen e Projekteve Infrastrukturore.

Aprovimin e kabinetit qeveritar e ka marrë edhe rekomandimi për presidentin e Kosovës, që ta autorizojë Ministrinë e Financave për nënshkrim të marrëveshjes së kredisë me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit për trajtimin e ujërave të zeza në Komunën e Gjilanit. Marrëveshja siguron një kredi në shumën prej 10 milionë eurosh. Në mbledhjen e së enjtes është aprovuar edhe konceptdokumenti për plotësimndryshimin e Ligjit për arkivat, i cili ka për qëllim përmirësimin, ngritjen dhe funksionalizimin e plotë të rrjetit arkivor, resurseve njerëzore, infrastrukturën fizike, grumbullimin e materialit arkivor, digjitalizimin e dokumenteve dhe të çështjeve të tjera që rregullojnë funksionimin e arkivave në Republikën e Kosovës. Qeveria ka miratuar edhe vendimin për themelimin e

## Burim Ramadani emërohet koordinator nacional për integrim dhe anëtarësim në NATO

Po në këtë mbledhje është plotësuar dhe ndryshuar vendimi i qeverisë për themelimin e Komitetit Ndërmintoror për Integrim dhe Anëtarësim në NATO. Ndërsa me një vendim të veçantë zëvendësministri i mbrojtjes, Burim Ramadani, është emëruar në pozitën e koordinatorit nacional për Integrim dhe Anëtarësim në NATO..

strukturave për zbatimin e pakos ligjore për administratën publike. Po në mbledhjen e së enjtes kryeministri Haradinaj ka kërkuar nga ministrat e resorëve përkatës që të përgatisin informata për kabinetin qeveritar për procesin e zbatimit të vendimit për kompensimin e dëmeve në bujqësi nga breshëri vitin e kaluar, për procesin e fuqizimit të bashkëpunimit me OJQ-të, për skemat pensionale dhe për procesin e përcaktimit të pagës

minimale. Me këtë rast, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skënder Reçica, ka prezantuar një informatë për kabinetin qeveritar për procesin që është duke u zhvilluar në reformimin e skemave pensionale në Kosovë.

Reçica është autorizuar që t'i përgatisë propozimet me shkrim për veprimet që duhet të ndër-marrë Qeveria në të ardhmen për reformimin e sistemit pensional në Republikën e Kosovës.

## Aeroporti i Gjakovës i jepet për shfrytëzim ushtrisë

Me qëllim të krijimit të kushteve të favorshme për operim, vendosjen e pajisjeve dhe sistemeve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për dhënien në shfrytëzim në kohë të pacaktuar të Aeroportit të Gjakovës Ministrisë së Mbrojtjes për nevojat e saj strategjike.

## Përfundon faza e parë e seleksionimit të kandidatëve për rekrutë të FSK-së

PRISHTINË, 18 PRILL (ER) - Ministria e Mbrojtjes prej datës 11 shkurt deri më 22 shkurt ka pasur të hapur konkursin e rregullt për pranimin e 650 rekrutëve të rinj në FSK. Në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej 6 759 persona, të cilët i janë nënshtruar fazës së parë të testimit.

Nga faza e parë e testimit, në një proces të drejtë, profesional dhe transparent të vlerësimit, bazuar në kriteret dhe standardet e përcaktuara për shërbim në FSK, për ta vazhduar garën e mëtejme janë përzgjedhur 1 029 kandidatë. Lista e kandidatëve është shpallur në uebfaqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes më 17 prill 2019.

Të gjithë ata që janë të pakënaqur

me fazën e parë të testimit dhe të përzgjedhjes, ankesat me shkrim duhet t'i dorëzojnë në Departamentin e Personelit, në Ministrinë e Mbrojtjes, në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, deri më datë 26 prill 2019. Ankesat duhet të dorëzohen gjatë ditëve të punës dhe brenda orarit të rregullt të punës. Të gjitha ankesat do të shqyrtohen sipas rregullave dhe procedurave ligjore. Të gjithë të ankuarve do t'u jepet mundësia që t'i shohin rezultatet e testeve të tyre dhe të njihen me procesin e vlerësimit. FSK-ja të gjitha detyrat i kryen me profesionalizëm, me përkushtim, me nder dhe me standardet më të larta ushtarake.



Flet për "Epokën e re", Ramë Vataj

# Politikanët e padijshëm më n

Kryetari i ri i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Therandë, Ramë Vataj, ka treguar arsyet e rikthimit në politikë pas pesë vjetësh. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se marrja e politikanëve të padijshëm me çështje akademike ka qenë arsyeja kryesore pse ka vendosur sërish të merret me jetën politike. Sipas tij, nuk duhet lejuar që politikanët analfabetë të vendosin për rektorë, profesorë apo për pozita të larta në universitetet publike. Vataj ka shprehur optimizëm se do ta fuqizojë PDK-në në këtë komunë, me aderime të reja, dhe kthimin e aktivistëve dhe anëtarëve të tjerë në 'shtëpinë e vjetër'. Ai ka thënë se PDK-ja në përfundim të procesit të zgjedhjeve të brendshme do të dalë më e fortë dhe më e konsoliduar se të gjitha partitë e tjera. Vataj ka pohuar se zgjedhjet në nivel kombëtar janë afër



**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 18 PRILL** - Kryetari i ri i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Therandë, Ramë Vataj, ka bërë me dije se shumë miq të tij dhe elektorati i PDK-së kanë ndikuar që t'i kthehet sërish jetës politike. Ai ka pranuar se shtytjen më të madhe për ta marrë këtë vendim ia kanë dhënë veprimet e politikanëve të padijshëm në çështjet akademike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se nuk duhet lejuar që për çështje të arsimit të marrin vendime politikanë të padijshëm. "Duhet theksuar që një shtytje të madhe për ta marrë këtë vendim janë disa veprime të politikanëve të padijshëm, mos të them analfabetë, të cilët duke qenë në pozita

të deputetit, ministrit, zëvendës-ministrit etj., të vendosin për çështje akademike. Këta të padijshëm vendosin për rektorë, për profesorë", ka thënë Vataj. Ai ka shprehur optimizëm se do ta fuqizojë PDK-në në këtë komunë, me aderime të reja dhe kthimin e aktivistëve dhe anëtarëve të tjerë në 'shtëpinë e vjetër'. Sipas Vatajt, procesi i brendshëm zgjedhor do ta konsolidojë dhe fuqizojë PDK-në. "Këto zgjedhje kanë treguar që PDK-ja në nivel të Kosovës, ka shtrirje të gjerë, elektorati i saj është besnik dhe sadopak lëvizjeve të vogla në partitë e tjera, ata do të rikthehen në PDK, sepse kanë kuptuar që vetëm PDK-ja dhe lideri i saj, z. Kadri Veseli, me një ekip të gjerë të intelektualëve mbrapa, mund t'i çojnë proceset e zhvillimit dhe shtetndërtimit përpara", është shprehur Vataj.



**"Epoka e re":** Z. Vataj, sapo jeni zgjedhur kryetar i Degës së PDK-së në Therandë. Si e kanë pritur elektorati dhe struktura e degës së partisë rikthimin tuaj?

**Vataj:** Në fillim ju përhëndes juve dhe lexuesit tuaj, duke ju falënderuar për interesimin rreth zhvillimeve të fundit në PDK, veçanërisht në Degën e Therandës. Kthimi im në PDK, në krye të Degës së PDK-së në Therandë, është bërë me kërkesën e një pjese të madhe të anëtarëve të devotshëm të PDK-së, themeluesve të saj dhe njerëzve të tjerë kontributdhënës para dhe pas luftës së fundit në Kosovë. Unë jam konsideruar faktor i unifikimit të të gjitha kategorive të mundshme të njerëzve, si ata intelektualë akademike, të kategorive të luftës, të burgosurve politikë, të studentëve dhe njerëzve punëtorë të thjeshtë për shkak të historisë sime familjare dhe përvojës akademike. Duke qenë se PDK-ja ka një elektorat shumë besnik, i cili në zgjedhjet e fundit ishte pasivizuar, për arsye që nuk mund t'i jap këtu; pastaj prej

dorëheqjes sime para pesë vjetëve, ka pasur një kohë pa kryetar të Degës, dhe strukturat janë pasivizuar dhe diku-diku janë shkapërderdhur, ka qenë kërkesë e të gjithë atyre që e duan PDK-në dhe rritjen e saj, të kthehem edhe një herë për ta riorganizuar dhe konsoliduar partinë, sikur më parë, kur edhe kemi dalë partia e parë në Komunën e Therandës në vitin 2010, në zgjedhjet e përgjithshme kombëtare. Kjo kërkesë ka qenë permanente, në çdo takim në raste të përvjetorëve dhe tubimeve përkujtimore, apo evenimenteve në kuadër të komunës, ku unë asnjëherë nuk kam munguar. Edhe në ditën e mbajtjes së Konventës Zgjedhore, më 14 prill, e tregoi vullneti i delegatëve, dëshirën e tyre për t'u kthyer si kryetar, ku unë mora shumicën e votave, në një garë fer dhe të fortë mes tre kandidatëve, ndërsa nuk kisha bërë asnjë ditë fushatë gjatë kuvendeve zgjedhore nëpër nëndegë.

**"Epoka e re":** Sa jeni të kënaqur

me angazhimin e të rinjve dhe personaliteteve të reja në këtë degë?

**Vataj:** Tani është herët të flas për angazhimin e të rinjve dhe personaliteteve të reja në Degën e Therandës sepse nuk kam qenë i kyçur fare nëpër tubimet partiake. Di një fakt që janë zgjedhur disa kryetarë të rinj, njerëz intelektualë, të cilët nuk i kam pasur në struktura udhëheqëse kur kam qenë unë kryetar i degës. Mund të flas vetëm për takimet individuale me njerëz intelektualë dhe të rinj studentë apo të diplomuar, të cilët kanë premtuar se do të inkuadrohen në PDK dhe aktivitete të saj, nëse unë do të jem kryetar i Degës së PDK-së sepse, siç janë shprehur ata, "duam të dimë pas kujt po shkojmë, e dimë kush na prin" etj! Jam optimist se do të ketë aderime të reja, po ashtu kthim të aktivistëve dhe anëtarëve të tjerë në "shtëpinë e vjetër", sepse e kanë kuptuar se askund nuk do të respektohen dhe vlerësohen më shumë se aty ku ka vlera. PDK-ja ka njerëz me vlera, të cilët e kanë dëshmuar vetën para luftës, në

# xitën t'i rikthehem politikës



luftë dhe pas luftës së fundit në Kosovë.

**"Epoka e re":** Për disa vjet ju u larguat nga politika. Pse vendoset t'i riktheheni sërish politikës?

**Vataj:** Për gati pesë vjet kam qenë jashtë politikës për shkak të pozitës së rektorit në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren. Duke parë zhvillimet politike në vend dhe nivelin intelektual të cilin e kemi në Qeveri dhe Kuvend, pastaj edhe kërkesat e shumta të shokëve, miqve, bashkëpunëtorëve të mi profesorë, njerëz të arsimit dhe shkencës, elektoratit të PDK-së, vendosa të kthehem në jetën politike. Duhet theksuar se një shtytje të madhe për ta marrë këtë vendim janë disa veprime të politikanëve të padijshëm, mos të them analfabetë, të cilët, duke qenë në pozita të deputetit, ministrit, zëvendësministrit etj., të vendosin për çështje akademike. Këta të padijshëm vendosin për rektorë, për profesorë, për pozita të larta qeveritare, të udhëheqësve të agjencive, bordeve të universiteteve e institucioneve të tjera publike,

se kush do të ketë hise më shumë të gllabërojnë gjithçka është e shtetit.

Ju si gazetarë mund ta dini, ose mund të hulumtoni, se kush janë anëtarë të këshillave drejtuese të universiteteve këtu në Prishtinë, në Prizren, në Mitrovicë etj. Është ofendim për të gjithë stafin akademik të universiteteve, që në Këshillin Drejtues të ketë mësues të shkollave të mesme, njerëz me mesatare në institucione private të dyshimta, vetëm të sapodiplomuar pa asnjë karrierë akademike e as jetësore në ndonjë institucion publik, kur Kosova ka shumë profesorë eminentë të dëshmuar gjatë karrierës së tyre akademike. Kush ka qenë kryetar i Këshillit Drejtues dhe anëtarë të tjerë të emëruar nga MASHT-i në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", kush është tash? Kush kanë qenë anëtarë të KD-së të emëruar nga MASHT-i në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren e kush është tash? E kështu me radhë... Njerëz që nuk dinë të flasin mirë shqip, e le më të shkruajnë drejtshkrim në shqip, vendosin për të ardhmen e

studentëve tanë, të zgjedhjes së udhëheqësve të institucioneve publike, punësimeve pa kritere, për të cilat do të paguajmë edhe disa vjet në të ardhmen. Po shihet si e kemi gjendjen aktuale, ku rinia çdo ditë po e lëshon Kosovën, meqë këtu nuk shoh perspektivë, edhe pse shteti i Kosovës ka investuar në shkollimin e tyre disavjeçarë, po kuadro të gatshme u shkojnë vendeve perëndimore.

**"Epoka e re":** PDK-ja deri tani ka përfunduar zgjedhjet e brendshme në shumë degë. Cili është vlerësimi juaj për këtë proces?

**Vataj:** Meqenëse nuk kam qenë pjesë aktive e procesit të zgjedhjeve në PDK nuk mund të flas me kompetencë për shkallën e realizueshmërisë së këtij procesi. Mirëpo nga ato që kam lexuar dhe dëgjuar përmes medieve, ky proces ka shkuar shumë mirë, në shumë degë janë zgjedhur kryetarë figura të reja intelektuale, apo njerëz me CV të mirë, të cilët janë prurje e re, që shton optimizmin e njerëzve dhe rritjen e besimit në Partinë Demokratike

të Kosovës, në vizionin e saj për shtetndërtim dhe zhvillim krahas vendeve të tjera të Evropës dhe besim në liderin e saj, z. Kadri Veseli.

**"Epoka e re":** Sa besoni se këto zgjedhje do të ndikojnë në fuqizimin e PDK-së, sepse sondazhet e fundit nuk po e nxjerrin mirë këtë parti?

**Vataj:** Këto zgjedhje kanë treguar se PDK-ja në nivel të Kosovës ka shtrirje të gjerë, elektorati i saj është besnik dhe, sadopak lëvizje të vogla në partitë e tjera, ato do të rikthehen në PDK, sepse kanë kuptuar që vetëm PDK-ja dhe lideri i saj, z. Kadri Veseli, me një ekip të gjerë të intelektualëve mbrapa, mund t'i çojnë proceset e zhvillimit dhe shtetndërtimit përpara. Ikja dhe pozicionimi i anëtarëve në parti të tjera, unë mendoj se është bërë për shkak të gjendjes së rëndë sociale, ku partitë e vogla, të cilat i ka "ngjallur" PDK-ja, me koalicionin e bërë së fundi, duke mos pasur mjaftueshëm anëtare, i ka futur nëpër punë të ndryshme, pa kritere, vetëm për përfitime poli-

tike. Kjo ish-anëtarësi e PDK-së nuk është me bindje në partinë tjetër. Është anëtarësi e interesit. Dhe kjo zgjat vetëm sa të zgjatë kontrata e përkohshme. Kur po e shohim që këta liderë dhe politikanë të partive të tjera të rritura artificialisht, me joshje, kanë punësuar anëtarët e vet të familjes apo akraballëkut të vet, atëherë zgjidhjen e qëndrueshme dhe afatgjatë e shohin në subjektin kur kanë pasur respekt më shumë, aty ka janë shumica e shokëve të hershëm që kanë ndarë çdo vështirësi mes vete, dhe shumica janë kthyer në PDK.

Nuk kam qasje në rezultate të sondazheve dhe nuk e di sa të besueshme mund të jenë ato, prandaj po ia lëmë kohës që ta japë sondazhin më të mirë sepse, siç po shihet, zgjedhjet në nivel kombëtar i kemi afër. Mendoj se PDK-ja procesin e zgjedhjeve të brendshme do ta përfundojë brenda muajit maj të këtij viti, me ç'rast do të dalë më e fortë dhe e konsoliduar se të gjitha partitë e tjera, dhe ajo do të jetë e gatshme për çfarëdo sfide.

# Veseli dhe Haradinaj presin në takim delegacionin e Batalionit 'Atlantiku'

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 PRILL - Me një minutë heshtje për dëshmorët ka filluar takimi i kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, me ish-pjesëtarë të Batalionit 'Atlantiku' të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët 20 vjet më parë nga Amerika iu bashkëngjitën luftës në Kosovë.

Kryeparlamentari Veseli ka thënë se lufta çlirimtare nuk do të kishte kuptim pa kontributin e bashkatdhetarëve. Ai ka çmuar lart gatishmërinë e bashkatdhetarëve për ta lënë jetën e rehatshme në shtëpitë e tyre dhe për t'iu bashkuar luftës çlirimtare në Kosovë deri në sakrificë.

Veseli ka thënë se vrasësit e tre dëshmorëve, vëllezërve Bytyçi, nuk

janë përgjigjur ende për krimin e tyre, edhe pse, sipas tij, ata janë të njohur. "Edhe pas dy dekadash shteti serb nuk po denjon t'i pranojë krimet që ka bërë në Kosovë, duke tentuar t'i mohojë masakrat mbi civilët e pafajshëm shqiptarë", ka theksuar Veseli. Ai ka thënë se është obligim i atyre që kanë mbetur gjallë, që ta vazhdojnë punën për forcimin e shtetit të Kosovës ngaqë, siç ka thënë ai, sa më i fortë të jetë shteti, aq më fuqishëm mund ta kërkojë të drejtën e vet.

Komandanti i Batalionit 'Atlantiku', Gani Shehu, ka thënë se ky batalion mblihdhte të rinj nga të gjitha trojet e gjeografisë shqiptare, duke përbërë kështu, siç pathënë ai, një Shqipëri në miniaturë. "Pas 20 vjetëve vendosëm ta rikujtojmë rrugëtimin tonë, duke përkujtuar gjithashtu të gjithë ata që dhanë



më së shumti, për të arritur këtu ku jemi, në shtetin e Kosovës, të lirë dhe pavarur. Sa herë që vijmë këtu shohim ndryshime pozitive. Ju falënderojmë juve si kryetar i Kuvendit dhe institucionet e tjera për punën në të mirë të qytetarëve dhe në të mirë të vendit", ka thënë Shehu.

Në takim diskutuan edhe anëtarë të tjerë të delegacionit, Mark Gjonaj, anëtar i Këshillit Bashkiak të Nju Jorkut, admiral Skënder Doçi, komandant i parë i batalionit, e të tjerë, të cilët evokuan kujtime nga lufta e 20 vjetëve më parë. Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka pritur në takim delegacionin e Batalionit 'Atlantiku'. Ai ka thënë se ishte

nder i jashtëzakonshëm t'i priste përfaqësuesit e këtij Batalioni që u rikthyen në vendin e tyre të origjinës, për shënimin e 20-vjetorit të themelimit, për t'u përlulur te varret e vëllezërve të tyre të armës, rënë në luftën çlirimtare. "Ata e braktisën jetën e ndërtuar përtej Atlantikut, për t'iu përgjigjur thirrjes së atdheut. 'Batalioni Atlantiku' është tregimi më kuptimplotë për luftëtarin shqiptar ndër breza, që sakrifikon gjithçka për t'iu bërë gurthemel lirisë. Ne u jemi mirënjohës për jetësisht shqiptaro-amerikanëve që dhanë kontributin e tyre në luftë dhe në liri, për forcimin e miqësisë së përhershme me ShBA-në", ka thënë Haradinaj.

## Bëhen homazhe te shtatorja e heroit Zahir Pajaziti dhe te varrezat e dëshmorëve në Velani

PRISHTINË, 18 PRILL (ER) - Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka nderuar të enjten dëshmorët e Prishtinës. Ai ka bërë homazhe te shtatorja e heroit të Kosovës, Zahir Pajaziti, dhe te Varrezat e Dëshmorëve në Velani. "Në ditën e sotme kujtojmë të rënë në masakrën e Makocit dhe

dëshmorët e martirët e Betejës së Marecit. Misioni ynë historik për liri dhe pavarësi u realizua falë veprës heroike të luftëtarëve çlirimtarë dhe sakrificës së martirëve të cilët gjithmonë do të jenë frymëzim dhe udhërrëfyes për ndërtimin e të sotmes dhe të ardhmes sonë", ka thënë

Haradinaj.

Me rastin e Ditës së Dëshmorëve të Prishtinës, edhe përfaqësues të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) kanë bërë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve në Velani dhe te shtatorja e heroit të Kosovës Zahir Pajaziti.



## Fillojnë stërvitjet shkollore për "zvogëlimin e rreziqeve nga tërmetet"



PRISHTINË, 18 PRILL (ER) - Agjencia e Menaxhimit Emergjent e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe institucioni përgjegjës i emergjencave i Republikës së Turisë AFAD, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit, kanë filluar zbatimin e projektit: "Zvogëlimi i rreziqeve nga tërmetet". Ky projekt ka për qëllim mbajtjen e stërvitjeve shkollore me simulator për tërmete. Trajnimi do të zgjasë pesë

javë, ndërsa gjatë tërë kësaj kohe automjeti me simulator nga Turqia do të qëndrojë në Kosovë. Qëllimi i kësaj stërvitjeje shkollore është sensibilizimi, njohja dhe përgatitja e nxënësve se si duhet të sillen dhe të mbrohen në rastet e tërmeteve.

Në kuadër të këtij ushtrimi janë paraparë të përshihen rajoni i Gjilanit në pesë komuna, rajoni i Prishtinës në pesë komuna, rajoni i Mitrovicës në pesë komuna,

Rajoni i Pejës në pesë komuna dhe rajoni i Prizrenit në pesë komuna. Agjencia për Menaxhim të Emergjencave e Ministrisë së Punëve të Brendshme, në kuadër të prioritetëve të veta strategjike, vazhdimisht harton plane të ushtrimeve operative, me qëllim të parandalimit të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera për përgatitjen e qytetarëve në rast se vendi ynë mund të ballafaqohet me ndonjë fatkeqësi.

# Kosova bëhet me program që mundëson reagim të shpejtë në rastet e infarkteve akute

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka bërë prezantimin e programit nacional i cili parasheh që në rast të infarkteve akute në krejt Kosovën të bëhet reagimi dhe raportimi i shpejtë i rasteve dhe pacienti të arrijë shpejtë në QKUK. Rreth 3 000 persona apo 35 për qind e të gjitha vdekjeve brenda vitit në Kosovë shkaktohen nga sëmundjet e zemrës. Për çdo vonesë prej 30 minutash pas infarktut, rreziku i vdekshmërisë rritet për 7.5 për qind



**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 18 PRILL** - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) të enjten ka bërë prezantimin e programit nacional i cili parasheh që në rast të infarkteve akute në krejt Kosovën të bëhet reagimi dhe raportimi i shpejtë i rasteve dhe pacienti të arrijë shpejt në QKUK. Përmes këtij projekti do të mundësohet që dukshëm të rritet koha e reagimit të rastet e infarkteve akute në nivel të krejt Kosovës dhe të bëhet raportimi i menjëhershëm i rasteve nga të gjitha qendrat e Kosovës. Duke folur për këtë projekt, ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se rreth 3 000 persona apo 35 për qind e të gjitha vdekjeve brenda vitit në Kosovë shkaktohen nga sëmundjet e zemrës. Ai ka

thënë se duke e parë këtë situatë, për herë të parë në Kosovë po krijohet programin kombëtar për trajtimin e infarktut në dy orët e para në të gjithë vendin. "Për çdo vonesë prej 30 minutash pas infarktut, rreziku i vdekshmërisë rritet për 7.5 për qind. Me këtë program, kur një qytetar do të ballafaqohet me sulmin në zemër, kudo që jeton ai në Kosovë, brenda dy orëve do të reagojë i gjithë zinxhiri shëndetësor, me procedura të përshpejtuara dhe pa asnjë vonesë do ta sjellë atë në QKUK për t'ia shpëtuar jetën. Me shërbimin 24-orësh për sëmundjet e zemrës dhe stentimin në QKUK dhe tani me këtë program, ne do t'i shtojmë ndjeshëm shanset e qytetarëve tanë për mbijetesë. Programi do të zhvillohet në tri faza dhe puna për realizimin e tij do të fillojë menjëherë", ka thënë

ministri Ismaili. Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës sot ka bërë prezantimin e programit nacional i cili parasheh që në rast të infarkteve akute në krejt Kosovën, të bëhet reagimi dhe raportimi i shpejtë i rasteve dhe pacienti të arrijë shpejt në QKUK. Përmes këtij projekti do të mundësohet që dukshëm të rritet koha e reagimit të rastet e infarkteve akute në nivel të krejt Kosovës dhe të bëhet raportimi i menjëhershëm i

rasteve nga të gjitha qendrat e Kosovës. Në anën tjetër, drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, dr. Basri Sejdiu, ka thënë se ky është projekti më i rëndësishëm në shëndetësi që nga paslufta. Sipas tij, brenda 120 minutave përmes këtij projekti arrihet të shpëtohet muskuli i zemrës dhe pacienti të mos mbetet me invaliditet. Drejtori Sejdiu foli edhe për punët dhe hapat që janë ndërmarrë, duke theksuar se tash-

më janë në funksion dy salla të kateterizimit dhe ka specialistë dhe staf tjetër të trajnuar. Ai ka folur edhe për historikun dhe koronarografinë e parë që është bërë në Kosovë. "Koronarografinë e parë e kemi bërë më 31 tetor të vitit 2003, ndërsa stentimi i parë më 5 mars 2005 nga ky ekip. Ekipi që ishte trajnuar atje nuk kishte arritur ta realizonte kardiologjinë invazive në QKUK për shkaqe objektive", ka theksuar drejtori Sejdiu.

## Veseli bën thirrje për forcim të luftës kundër korrupsionit

**PRISHTINË, 18 PRILL (ER)** - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, në konferencën e organizuar nga Ministria e Drejtësisë, për rishikimin funksional të sektorit të sundimit të ligjit, ka përsëritur edhe një herë qëndrimin e tij për luftë të pakompromis kundër korrupsionit dhe dukurive të tjera negative, për çfarë i ka ftuar institucionet përgjegjëse që të punojnë më shumë.

Duke folur para të pranishmëve, Veseli ka thënë se nëpërmjet korrupsionit po dëmtohen qytetarët e Kosovës, shteti dhe perspektiva e tij. "Korrupsionin mund dhe duhet ta ndalim vetë, secili, pa mëshirë. Duhet ngushtuar hapësirën për njerëzit e korrupsionar, që nga politikanët, nga të cilët kemi mjaft dhe flasin më së shumti. Por nganjëherë duhet sanksionuar edhe gjyqtarët e prokurorët, në mënyrë që ta kryejnë punën e tyre, ngaqë gjyqësori duhet të jetë i paanshëm", ka theksuar kryeparlamentari Veseli. Ai shfaqti besimin se me

reformat që kanë ndodhur në sistemin gjyqësor dhe me kapacitetet aktuale, ka mundësi dhe, siç ka thënë ai, ka heronj të cilët do të dalin dhe do të ngrehin aktakuza edhe për njerëz të profilit të lartë politik. Kreu i Kuvendit ka thënë se njerëzit janë duke ikur nga Kosova, para së gjithash, sepse atyre u ka humbur besimi dhe ai besim duhet rikthyer. Në këtë konferencë u paraqit edhe vizioni për formimin e Gjykatës Komerciale e cila është propozuar nga kryeparlamentari Kadri Veseli dhe do t'u mundësojë bizneseve që t'i zgjidhin më shpejt kontestet e tyre. Duke folur për investimet dhe bizneset në Kosovë, kryeparlamentari Veseli ka thënë se vonesat për zgjidhjen e kontesteve kanë shkaktuar probleme të mëdha në funksionimin e tyre, por edhe në ardhjen e investitorëve të rinj nga jashtë. Ai ka shtuar se Kosova ka resurse të jashtëzakonshme humane dhe natyrore për zhvillim dhe për të mbajtur brenda



njerëzit e saj. Kjo, sipas tij, bazohet në një strategji të mirëfilltë ekonomike, e cila bazamentin e ka në praktikën më të avancuar të ndërmarrësisë dhe ekonomisë së lirë private. "Kjo është arsyeja pse e kemi shtyrë përpara procesin e

rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit dhe e përgëzoj ministrin për hapat konkretë në këtë drejtim. Besoj se në një kohë rekorde do ta miratojnë ligjin në Kuvend dhe ta krijojmë infrastrukturën e nevojshme për

funksionalizimin e shpejtë të gjykatave komerciale", ka deklaruar Veseli. Ai ka shtuar nevojën e harmonizimit të ligjeve, në mënyrë që të mos ketë ndërlikime dhe, për rrjedhojë, moszbatim të tyre në praktikë.

# SIGURIMI I USHQIMIT ËSHTË PRIORITET NDËR PRIORITETE



Shkruan: Prof. dr. Imer  
R. RUSINOVCI

Bujqësia bashkëkohore e shekullit XXI karakterizohet me mungesa të panumërta të drejtimeve të zhvillimit të ardhshëm. Sistemet e bujqësisë që praktikohen në botë dhe në vendin tonë janë të ndryshme, varësisht nga shkalla e intensitetit dhe masave që përfshihen, por që zhvillohen në bazë të kushteve specifike mjedisore, ekonomike dhe sociale në vende të veçanta. Në pragun e mijëvjeçarit të tretë paraqiten pamje të reja përkatësisht filozofi të reja të zhvillimit të ardhshëm të bujqësisë. Intensifikimi i prodhimit të bimëve të arave, në këtë periudhë duhet të bazohet në konceptet e rëndësishme që ofrojnë ndryshimet në teknologjitë kultivuese të kultivimit e bimëve. Natyrisht, sistemet e tilla të bujqësisë gjithsesi duhet të bazohen në një bazë efektive ekonomike për bujqësi të qëndrueshme, një koncept i parashikuar i zhvillimit të ardhshëm të bujqësisë.

Më shumë se 90 për qind e ushqimit burimin e ka nga bimët lavertare, andaj kultivimi i këtyre bimëve përfaqëson bazën e ushqimit të njerëzve dhe kategorive të ndryshme të kafshëve shtëpiake. Përveç sigurimit të ushqimit, bimët lavertare sigurojnë edhe lëndët e para në industrinë ushqimore, tekstilore, farmaceutike, kimike dhe industri tjera, madje kohëve të fundit, gjithnjë e më shumë

bimët lavertare po dedikohen edhe për prodhim të biodiselit e bioetanolit.

Të gjitha kulturat lavertare janë të rëndësishme, porse me interes vital dhe strategjik janë: gruri, orizi dhe misri (pa i eliminuar nga kjo rëndësi edhe pataten, luledielli, sojën dhe panxharsheqerin).

Sigurimi i ushqimit është çelës i zhvillimit ekonomik të çdo vendi. Amerikanët e pasur, konsumojnë ushqim vjetor i cili përfaqësohet nga: 115 kg/capita mish (me prodhime të mishit) dhe 271 litra qumësht/capita (me prodhime të qumështit), përderisa popujt e varfër në ushqimet e tyre shumë pak kalorike, konsumojnë më pak se ¼ e kësaj sasive të mishit dhe mezi 1 për qind të qumështit dhe prodhimeve të qumështit në raport me amerikanët. Sot jeta mesatare e njerëzve është 65 vite (nga 36 vite në Siera Leone deri në 80 vite në Japoni). Në SHBA jeta mesatare e meshkujve është 72 vite, ndërsa e femrave.

Bota shumë shpejtë do të ketë 8 miliardë banorë. Shtimi vjetor i popullatës është rreth 100 milion banorë, ndërsa gjenerata e vjetër do të ketë zgjatje të mesatare jetësore dhe hulumtimet shkencore në SHBA tregojnë se në vitin 2030 amerikanët do të kenë 70 milionë banorë më të vjetër se 65 vite dhe 8 milionë banorë më të vjetër se 85 vite.

Qëllim i agronomisë në të ardhmen, është që të varfërve t'ua ndryshojë (përmirësojë) ushqimin, ndërsa të pasurit t'i ushqejë në vazhdimësi. Problemi kryesor është toka bujqësore, e cila në vende të ndryshme haset në përmasa shumë të pabarabarta, si:

a) Kanada posedon 1,0 ha/capita tokë pune dhe 0,5 ha/capita tokë pyjore (Kanada shquhet edhe për prodhimin e letrës);

b) Mesatarja botërore sillet 0,30 ha/capita tokë pune, porse ka edhe më keq si

c) Kenia posedon nën 0,10 ha/capita dhe

d) Kinezët shfrytëzojnë 0,08 ha/capita.

Kur kësaj ja shtojmë nevojat, rëndësinë dhe mungesën e ujit shohim se në një vend ku zbatohet ujitja, prodhimet janë më të larta për 2,5 herë në raport me kushtet aride. Pavarësisht këtyre dukurive, në rangun botëror kërkohet që prodhimi të shtohet çdo vit në shkallë 2 për qind, andaj këtë problem e rregullon shkenca dhe praktika, pavarësisht se zbulimet shkencore nuk janë të sigurta, madje shpesh janë të rastit.

## Çka është sot më e rëndësishmja

1. Patjetër duhet t'i ndryshojmë teknologjitë kultivuese (agroteknikën),
  2. Të kemi ngritje 2 për qind të prodhimit të bimëve të arave çdo vit (krahas rritjes botërore të prodhimit të këtyre kulturave),
  3. Kostot e prodhimeve strategjike vazhdimisht duhet të mbështeten nga shteti,
  4. Ekspertët duhet t'i bartin dhe t'i zgjerojnë sa më shumë te fermerët, njohuritë e reja për teknologjitë kultivuese dhe prodhimtari sa më të lartë.
- Prodhimtaria lavertare karakterizohet nga një ndryshim i rëndësishëm midis periudhës vegetative dhe kohëzgjatjes së prodhimit. Kështu p.sh. kultivimi i grurit në kushtet tona zgjat rreth 250 ditë, ndërsa kultivimi i misrit 100-150 ditë (varësisht nga hibridet që kultivohen). Prioritetet në konceptin e ardhshëm të zhvillimit të bujqësisë duhet të adresohen në: a) Politika dhe praktika të mirëfillta

agrarë në nivel shtetëror e rajonal, me theks të veçantë në cilësinë dhe diversitetin (me mbështetje konkrete të vazhdueshme) dhe b) Demonstrimi i fleksibilitetit agronomik dhe ekonomik, përfitimet sociale dhe konvergenca e popullsisë rurale e urbane, si dhe zvogëlimi i dallimeve ndërmjet prodhuesve dhe konsumatorëve.

Teknologjitë e zhvillimit të bujqësisë gjatë fillimit të këtij shekulli po mbështesin rritjet intensive me çdo çmim, me shfrytëzimin e burimeve natyrore, duke neglizhuar një pjesë të madhe postulatet bazë ekologjike. Për këtë menaxhim të burimeve duhet të mendohet, sepse po na prodhon shumë probleme mjedisore, përkatësisht pasojat që do t'ua lëmë gjeneratave të ardhshme që vijnë pas nesh. Një alternativë e besueshme për zhvillimin e një labirinthi të tillë, po shënohet nga një zhvillim i qëndrueshëm sintagmatik. Për të arritur qëndrueshmërinë globale, është e nevojshme të rishqyrtohet mendimi për ekologjinë dhe ekonominë, krahas qëllimeve kundërshtarë. Mendimi global mbi këtë temë ka çuar gjithashtu në rezultatet e para të bujqësisë, të cilat kanë për qëllim çmontimin e prodhimit konvencional të klasit botëror dhe se efektet negative të një zhvillimi të tillë janë zhvendosur ngadalë drejt drejtimeve të caktuara alternative të bazuara në themelet biologjike. Thelbi i filozofisë së re agronomike konsiston në procesin e ndryshimeve në të cilat përdorimi dhe ruajtja e burimeve natyrore të renovueshme dhe jo të renovueshme janë thelbësore për zhvillimin e teknologjisë, investimin dhe institucionalizimin e ndryshimeve që duhet të jenë në harmoni të plotë. Mendime të

tilla duhet të ndiqen nga një qasje holistike për jetën dhe zhvillimin, si dhe aktivitetet që duhet të mundësojnë përmbushjen e nevojave dhe dëshirave të sotme por edhe të ardhshme njerëzore. Tranzicioni në sistemet tradicionale bujqësore, me teknologji intensive bujqësore (punimi konvencional i tokës, sasi të mëdha të plehrave minerale dhe pesticideve) karakterizohet me sisteme të qëndrueshme, që udhëhiqen përmes të ashtuquajturave teknologji të "inputeve të ulëta", si rezultat i dominimit të paradigmes ekologjike.

Kushtet prodhuese - klimatike gjejnë zgjidhjeve të reja në teknologjinë e kultivimit jo vetëm të vlerave vegjetale dhe veçanërisht specieve perimore. Zgjidhjet e tilla përfshijnë praktikën kulturore fleksibël që do të përfaqësojnë një bashkim të metodave konvencionale me teknologjitë moderne (metodat e ruajtjes së tokës, qarkullimit bimor me pjesëmarrje të larta të bishtajoreve, menaxhimin e integruar të dëmtuesve, varietetet e duhura dhe farërat cilësore). E gjithë kjo është një labirinth i ndarjes së fuqisë teknike dhe ekonomike të shtetit. Në këtë drejtim, prioritet u jepet ndërtimit të sistemeve të tilla, mbi të gjitha në nivel shtetëror (porse edhe në nivel rajonal), me theks në cilësinë dhe diversitetin e produkteve bujqësore. Nga ana tjetër, fleksibiliteti agronomik dhe ekonomik i sistemeve të qëndrueshme duhet të realizojë një funksion të caktuar shoqëror të popullatës së ngushtë rurale në zonat urbane, si dhe të zvogëlojë dallimin mes prodhuesve dhe konsumatorëve. Rendimenti i prithshëm i parashikuar duhet gjithashtu të ketë përkufizime më të sakta në segmentet e caktuara, të cilat janë të rëndësishme për prodhimin e bimëve.

## Filluan punimet në rrugën Gërlicë e Epërme - Shtërpçë - Brezovicë



SHTËRËPÇË, 18 PRILL (ER) - Ministri i Infrastrukturs dhe Transportit, Pal Lekaj, të enjten mori pjesë në përrurimin e fillimit të punimeve për rehabilitimin e rrugës regionale Gërlicë e Epërme - Shtërpçë - Brezovicë. Rehabilitimi i kësaj rruge me gjatësi prej 15.3 kilometrash dhe ka kosto mbi 1.2 milion euro. Punimet për këtë segment parashihet të përfun-

dojnë brenda 180 ditë pune. Ndërkaq për segmentin e dytë të rrugës deri në Qendrën e Skijimit dhe Prevallë, me gjatësi prej 19.4 kilometrash, të enjten është nënshkruar kontrata me vlerë afër dy milionë euro. Ministri Lekaj ka shprehur kënaqësinë që me këtë investim të Ministrisë së Infrastrukturs dhe Transportit i hapet perspektivë edhe më e madhe kësaj zone turistike. Ai

ka shtuar se Qeveria e Kosovës ka prioritet investimin në turizëm në të gjitha rajonet e Kosovës ku ka potencial turistik.

Kryetari i Federatës së Skijimit të Kosovës, Milaim Kelmendi, e ka falënderuar ministrin Lekaj që nëpërmjet infrastrukturs po lehtëson zhvillimin e sportit që ai përfaqëson jo vetëm në Brezovicë, por edhe në bjeshkët e tjera.



# BERZh-i do ta vazhdojë mbështetjen e projekteve për Kosovën



**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 18 PRILL** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të enjten në takim presidentin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), Suma Chakrabarti, me të cilin ka biseduar për projektet që janë duke u realizuar dhe për mundësinë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe BERZh.

Gjatë takimit kryeministri Haradinaj ka falënderuar presidentin Chakrabarti dhe

Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për bashkëpunimin dhe përkrahjen e projekteve konkrete zhvillimore për Kosovën si dhe projekteve që ndërlihen me integrimin ekonomik rajonal, të financuara nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Kryeministri Haradinaj ka shprehur zotimin e Qeverisë së Kosovës dhe përkushtimin për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, për realizimin e projekteve infrastrukturore, përfundimin e autostradës Prishtinë - Merdare, investimet në rehabilitimin e

rrjetit hekurudhor, përfshirë Linjën Fushë-Kosovë-Podujevë Merdare, studimin e fizibilitetit për linjën hekurudhore Prishtinë - Aeroporti Ndërkombëtar "Adem Jashari", përfundimin e procedurave për rrugën Kijevë - Pejë dhe fillimin e implementimit të këtij projekti.

Duke kërkuar mbështetjen e mëtejme të BERZh-it, kryeministri Haradinaj e ka njoftuar presidentin Chakrabarti për prioritetet e qeverisë në zhvillimin ekonomik, Agjendën e Reformave Evropiane, forcimin e sundimit të rendit dhe të ligjit dhe çështje të

tjera me rëndësi për vendin.

Në takim u diskutua edhe për fillimin e realizimit të projektit të unazës së Prishtinës, trajtimin e ujërave të zeza, procesin e privatizimit të Telekomit, investimet në prodhimin e energjisë së ripërtrishme dhe projekte të tjera që kanë të bëjnë me infrastrukturën e qyteteve të tjera të Kosovës.

Ndërkaq presidenti i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Suma Chakrabarti, duke vlerësuar përparmin e Kosovës në shumë fusha, ka thënë se BERZh-i do ta vazhdojë mbështetjen e projekteve të cilat ndihmojnë

zhvillimin ekonomik të vendit dhe procesin e integrimi rajonale. Edhe ministri i Financave, Bedri Hamza, ka pritur në takim presidentin e BERZh-it Suma Chakrabarti. Në këtë takim u bisedua për marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe BERZh-it, për vazhdimin e bashkëpunimit financiar ndërmjet dy institucioneve si dhe për implementimin e projekteve të cilat ndikojnë në zhvillimin ekonomik të Kosovës, në veçanti për projektet infrastrukturore në sektorin e transportit, ujitjes dhe mbështetjen e skemës për garantimin e kredive.

## Ministri Shala: Prioritet imi është përkrahja e prodhuesve



**PRISHTINË, 18 PRILL (ER)** - Me ftesë të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka marrë pjesë në platformën "Business Talks", ku ka bashkëbiseduar me bizneset. Shala ka theksuar se prioritet i tij si ministër është përkrahja e prodhuesve vendorë dhe fuqizimi i tyre. "Përmes kësaj synojmë rritjen ekonomike dhe hapjen e vendeve të reja të punës", ka thënë Shala.

Ai ka potencuar se MTI-ja ka bërë ndryshim të udhëzimit administrativ në Ligjin për Investime Strategjike dhe pas kësaj kanë pranuar mbi 15 aplikacione nga investitorët potencialë. "Sowi Kosova LLC ka marrë statusin e investitorit dhe do ta bëjë investimin më të madh direkt në Kosovë, 169 milionë euro. Siç tashmë e dini, kemi bërë ofertë

konkrete edhe për gjigantin gjerman të prodhimit të veturave 'Volkswagen' dhe, po ashtu, jemi në proces të draftimit edhe të shumë letra-ofertave edhe për kompani të tjera, duke dëshmuar fokusin kryesor për rritjen e investimeve të huaja", ka theksuar ministri Shala. Ai ka shtuar se mbrojtja e konsumatorit është, po ashtu prioritet pasi, sipas tij, kjo është dëshmuar me punë konkrete, duke asgjësuar mbi 17 000 njësi të lodrave që kanë ardhur nga tregu aziatik, të cilat kanë rezultuar se janë të dëmshme për shëndetin e fëmijëve. "Puna do të vazhdojë edhe në dikastere të tjera, por prioritet absolut imi është dhe do të mbetet përkrahja e prodhimit vendor, rritja e investimeve të huaja dhe mbrojtja e konsumatorit", ka thënë ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala.

## MMPH-ja dhe UN-HABITAT-i ndihmojnë komunat për hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor

OHËR, 18 PRILL (ER) - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), me përkrahjen e Programit për Zhvillim Gjithëpërfshirës, implementuar nga UN-HABITAT në partneritet me PAX dhe CBM, financuar nga Qeveria e Suedisë, ka mbajtur punëtorinë e vizionimit dhe planifikimit urban për komunat: Zubin Potok, Mitrovicë Veriore, Zvečan dhe Leposaviq, e cila po mbahet në Ohër të Maqedonisë së Veriut. Me qëllim të shkëmbimit të përvojave për hartimin e dokumenteve të planifikimit urban, pjesëmarrëse në cilësinë e mysafirëve ishin edhe komuna e Kamenicës dhe Graçanicës.

Në hapje të kësaj punëtorie, sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Arben Çitaku, së bashku me ekipin e MMPH-së, Leutrim Sahiti, këshilltar politik dhe Servet Spahiu, drejtor i DPHBN-së, në emër të ministrit Fatmir Matoshi ka falënderuar UN-HABITAT-in

për përkrahjen që po ua jep komunave të Kosovës për hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor në nivel komunal dhe është shprehur që MMPH-ja do t'i mbështesë çdoherë komunat e Kosovës në këtë fushë dhe në fusha të tjera që mbulon Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Drejtoresha e UN-HABITAT-it në Kosovë, Gwendoline Mennetrier, ka theksuar se kjo punëtori ndihmon komunat tona partnere të gjenerojnë ide inovative dhe konstruktive në drejtim të zhvillimit të planeve të tyre komunale të komunave respektive. Mennetrier ka vlerësuar që kjo punëtori është një hap qenësor për rritjen efikase të ofrimit të shërbimeve për qytetarët e komunave respektive si dhe për forcimin e bashkëpunimit nderkomunal dhe ndërinstytucional. Ajo në fund u shpreh e impresionuar me punën e tyre.

Në emër të komunave pjesëmarrëse ka folur drejtori i Urbanizmit në



Komunën e Mitrovicës Veriore, Dejan Krsmanovic, i cili ka falënderuar MMPH-në dhe UN-HABITAT-in për realizimin e kësaj punëtorie që, sipas tij, është mjaft e rëndësishme në rrugën e tyre të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor, e cila, në veçanti, do ta japë drejtimin e zhvillimit për planet zhvillimore

komunale, vlerësimin strategjik mjedisor dhe hartat zonale.

Gjatë kësaj punëtorie, komunat kanë marrë njohuri nga zyrtarë të MMPH-së dhe UN-HABITAT-it mbi procedurat e hartimit të dokumenteve të planifikimit, duke përfshirë planin zhvillimor komunal, hartën zonale, vlerësimet strategjike mjedisore

dhe planet e tjera sektoriale. Në kuadër të punëtorisë, komunat kanë paraqitur vizionet, qëllimet, objektivat dhe aktivitetet e ndërlidhura me legjislacionin e Kosovës për planifikimin hapësinor, përfshirë banimin, infrastrukturën, ekonominë dhe mjedisin që ngërthejnë në vete edhe fusha të tjera tematike.

## Një kompani turke e interesuar të investojë në Malishevë



MALISHEVË, 18 PRILL (ER) - Komunën e Malishevës e kanë vizituar drejtori i TEB-it në Kosovë, Orcun Ozddenir, dhe biznesmeni turk, pronar i kompanisë "Sev Triko", Yusuf Eldeleklioglu, të cilët janë pritur nga kryetari i kësaj komune, Ragip Begaj, ndërsa në këtë takim ishte i pranishëm edhe deputeti i Kuvendit të Kosovës,

Enver Hoti. Qëllimi i këtij takimi ishte njohja me mundësitë dhe kushtet që ofron Malisheva për investimet e huaja, përkatësisht investimin nga një kompani turke që merret me tekstil dhe prodhon linja tekstili për firmat e njohura të veshjeve. Në këtë takim, kryetari Begaj i ka njoftuar me mundësitë që i ofron Komuna e Malishevës

për investime dhe gatishmërinë e komunës për të ofruar lehtësira për të gjithë ata që duan të investojnë në këtë qytet. Edhe deputeti Enver Hoti i ka njoftuar me mundësitë që ofrohen në vendin tonë për investime. Sipas tij, Kosova e ka të rregulluar infrastrukturën ligjore për investime dhe ofron shumë mundësi.

## Muharremaj, pjesë e konferencës 'Adaptimi i komunave në ndryshimet klimatike'

SUHAREKË, 18 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka marrë pjesë në konferencën 'Adaptimi i komunave në ndryshimet klimatike' e cila mbledh rreth vetes komunat nga tërë rrafshi i Dukagjinit. Muharremaj ka thënë se konferenca të tilla mund të ndikojnë

në ndryshime të mëdha në komunat e Kosovës. "Sadopak dhe simbolike të jenë angazhimet tona, mund të ndikojnë në ndryshime të mëdha, prandaj inkuadrimi me aktivitetet do ta ketë fokusin edhe në këtë segment", ka thënë Muharremaj.



## Promovohet bashkëpunimi ndërmjet Kuvendit Komunal të Kaçanikut dhe atij të Ferizajt



Kaçanik, 18 prill (ER) - Në vazhden e aktiviteteve të përbashkëta në mes të komunave, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Kaçanikut, Kemajl Murseli, ka pritur në takim homologen nga Ferizaj, Kristina Gashi-Bytyçi. Në këtë takim janë shkëmbyer

përvojat dhe sfidat me të cilat ballafaqohen kuvendet komunale, ndërsa me theks të veçantë është diskutuar për udhëzimet e reja administrative që ndërlidhen me punën e kuvendeve komunale. Kryesuesi Murseli ka falënderuar mysafirët nga

Komuna e Ferizajt për vizitën e realizuar në Komunën e Kaçanikut, derisa ka uruar që bashkëpunime të tilla të vazhdojnë edhe me komunat e tjera të regjionit, me qëllim të ndarjes së përvojave të mira dhe sfidave të kuvendeve komunale.

# 246 kërkesa për legalizimin e armëve marrin pëlqimin e MPB-së

Në katër muajt e fundit 718 qytetarë kanë parashtruar kërkesë për legalizimin e armëve, ku 246 prej tyre kanë marrë pëlqimin nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Zëvendësministri i MPB-së, Izmi Zeka, ka thënë se qëllimi i kësaj iniciative është që qytetarëve t'u jepet mundësia për ta zotëruar ligjërisht një armë sipas kushteve të Ligjit për Armët

EPOKA  
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 18 PRILL - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka mbajtur konferencë në kuadër të fushatës për legalizimin e armëve, me këtë rast është bërë edhe dhënia e pëlqimeve për armët për qytetarët që kanë aplikuar në kuadër të procesit të legalizimit. Me këtë rast, zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, i cili njëherazi është Udhëheqës i Komisionit për Armë të Vogla dhe të Lehta, ka theksuar se më 3 dhjetor 2018, ministri i Punëve të Brendshme nënshkroi një vendim për ta hapur afatin kohor për legalizimin e armëve, i cili do të zgjaste gjashtë muaj, duke filluar më 17 dhjetor 2019 dhe duke përfunduar më 17 qershor 2019. Ai ka thënë se kjo iniciativë ofron mundësinë që qytetarët e Kosovës t'i legalizojnë armët nga kategoritë B, C dhe D, në një periudhë amnistie për posedimin e paligjshëm të

armëve. "Në katër muajt e fundit, 718 qytetarë e kanë shfrytëzuar këtë mundësi dhe kanë parashtruar kërkesa për legalizim, 246 kanë marrë pëlqimin nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe sot unë do t'i dorëzoj personalisht dhjetë pëlqime", është shprehur zëvendësministri Zeka. Ai sërish u bëri thirrje qytetarëve të tjerë që kanë një armë të paligjshme ta ndjekin shembullin e tyre që kanë aplikuar. Zëvendësministri Zeka ka thënë se qëllimi i kësaj iniciative është që qytetarëve t'u jepet mundësia për të zotëruar ligjërisht një armë sipas kushteve të Ligjit për Armët, i cili është i harmonizuar me Direktivën e Armëve të Zjarrit të Bashkimit Evropian. Ndërsa Gazmend Hoxha nga Policia e Kosovës ka theksuar se Policia e Kosovës e vlerëson shumë këtë fushatë dhe është aktive për pranimin e aplikacioneve të qytetarëve. "Deri më tani kjo fshatë ka shkuar jashtëzakonisht mirë dhe ka pasur interesim. Duhet të



motivohen qytetarët që të bëhen pjesë e këtij procesi. Ne besojmë se kjo do të kontribuojë në përmirësimin e situatës së sigurisë në Kosovë, në veçanti në uljen e krimeve në të cilat përdoren armët", ka thënë Hoxha. Asistentja e përfaqësueses së përhershme dhe koordinatoresha e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Kosovë (UNDP), Valbona Bogujevci, vuri në dukje se kontrolli i armëve të vogla dhe të

lehta ka marrë përsëri vëmendje edhe në nivel global, edhe në nivel rajonal. "Dëshiroj t'i përgëzojë institucionet e Kosovës që ishin të parat në rajon që ndryshuan dhe miratuan strategjinë për armë të lehta dhe të vogla", ka thënë Bogujevci. Ajo ka shtuar se UNDP-ja do të qëndrojë e përkushtuar që t'i përkrahë institucionet e Kosovës edhe më tutje në zbatimin e aktiviteteve. Ajo vlerësoi fushatën për legalizimin e

armëve dhe iu bashkëngjiti parafolësve për t'iu bërë thirrje qytetarëve të cilët kanë armë ilegale që t'i bashkohen pjesës tjetër të qytetarëve që janë bërë pjesë e legalizimit të armëve. Periudha e legalizimit është e hapur edhe për dy muaj. Pas kësaj periudhe armët e paligjshme do të konfiskohen dhe dënimi për posedim ilegal të armëve mund të dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7 500) euro, ose me burgim deri në dhjetë (10) vjet.

## Ministri Gashi: Të hartohet një ligj që përkon me kërkesat e të rinjve

EPOKA  
ERE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 18 PRILL - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) ka bërë të enjten prezantimin dhe diskutimin e projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë. Në këtë prezantim, pas diskutimeve të bëra rreth këtij drafti, u dhanë edhe rekomandime. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në këtë takim u shpreh se Ligji për Rini medoemos kërkon ndryshime dhe plotësime. "Ka kaluar më shumë se një dekadë që kemi në fuqi një ligj për rini. Besoj se ka ardhur koha që ta kemi një ligj të ri që iu përshtatet nevojave dhe kërkesave të të rinjve. Gjatë takimeve me të rinj anekënd Kosovës është atakuar si problem kufizimi i moshës në ligj dhe besoj se ky ligj do ta definojë këtë kërkesë të të rinjve", ka thënë ai. Ministri Gashi ka theksuar se në ligjin e ri duhet të kemi tri

fokuse: përcaktimin e moshës, fuqizimin e mekanizmave rinorë dhe përcaktimin e qartë rolit të tyre dhe njohjen e punës vullnetare si përvojë e punës. "Një çështje që është shumë me rëndësi është ajo e mekanizmave rinorë në Kosovë që janë Këshilli i Veprimit Qendror të Kosovës, këshillat lokale nëpër komuna, qendrat e rinisë dhe organizatat rinore. Është mirë që me këtë plotësim dhe ndryshim të përcaktohen qartë mekanizmat rinorë në Kosovë dhe përgjegjësitë e tyre sepse këshillat e veprimit rinor lokal nuk e kanë kryer misionin e vet për çka janë themeluar, nuk e kanë luajtur rolin këshillëdhënës", ka thënë ministri Gashi. Ai, po ashtu, ka përmendur si shumë të rëndësishme fuqizimin e qendrave rinore sepse, siç ka thënë, aktualisht nuk janë duke funksionuar, nuk kanë ndonjë qëndrueshmëri. "Ajo që, po ashtu, do të jetë kërkesë dhe fokus në këtë ligj, është puna vullnetare. Në Kosovë ka problem të madh me të rinjtë që



aplikojnë për vende të punës sepse kërkesa e parë është përvoja e punës. Prandaj ligji duhet të përcaktojë qartë që çdo i ri dhe e re që bën punë vullnetare duhet t'i njihet si përvoja e punës. Besoj se tashmë e kemi edhe një platformë të mirë të regjistrimit të vullnetarëve dhe përmes kësaj platforme të përcaktohet qartë puna vullnetare duke respektuar çdo rregull dhe çdo kriter të përcaktuar me akte

të tjera nënligjore", u shpreh ministri Gashi. Në fund, ministri ka thënë se nuk do të mungojë mbështetja e tij dhe e kabinetit ndaj grupit punues, duke ua bërë me dije se është përgjegjësi e tyre për ta bërë një ligj jo sa për sy e faqe, por një ligj që përkon me kërkesat e të rinjve. Ndërkaq drejtori i Departamentit të Rinisë në MKRS, Feim Hoxha, ka thënë se dokumenti i strategjisë tanimë

ka marrë formën finale dhe gjatë këtyre ditëve ky dokument do të procedohet te ministri për aprovim. "Duke marrë parasysh se Ligji për Rini është aprovuar në vitin 2009 dhe ndryshimet që kanë ndodhur nga ajo kohë deri tani na kanë shtyrë që ne ta fillojmë iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji. Ne do të përpiqemi që gjatë këtij viti ligji të kalojë në qeveri", ka thënë Hoxha.


## Këshilltarja e Trumpit zhvillon bisedime në Moskë

MOSKË, 18 PRILL - Fiona Hill, këshilltarja e presidentit amerikan Donald Trump, ka udhëtuar në Rusi për të zhvilluar negociata me zyrtarë rusë, ka njoftuar zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov. Hill ka zhvilluar bisedime në Moskë më 17 prill me disa zyrtarë rusë, duke përfshirë ndihmësin e Kremlinit,

Yuri Ushakov, ka thënë Peskov. Një zyrtar i Ambasadës Amerikane, që ka kërkuar të jetë anonim, ka konfirmuar vizitën e zyrtares Hill për agjencinë e lajmeve "Associated Press". Hill është drejtore për çështjet evropiane dhe ato ruse në Këshillin Amerikan për Siguri

Kombëtare. Peskov ka thënë se Hilli dhe zyrtarët rusë kanë diskutuar çështje bilaterale dhe jo për ndonjë takim të mundshëm në mes të presidentit rus, Vladimir Putin dhe homologut të tij amerikan. Ky lajm ka ardhur në ditën kur Departamenti Amerikan i Drejtësisë pritet të publikojë një version të redak-

tuar të raportit të Këshilltarit Special, Robert Mueller, lidhur me hetimet që ka zhvilluar ai për ndonjë ndërhyrje të mundshme ruse në fushatën e Trumpit. Moska ka mohuar të ketë pasur ndonjë rol, derisa Peskov ka deklaruar më 18 prill se raporti nuk është i rëndësishëm.



# Barr: Muelleri nuk ka gjetur se Trumpi ka penguar drejtësinë

Prokurori i Përgjithshëm amerikan, William Barr, ka thënë se hetimet e Muellerit kanë gjetur të dhëna se Rusia ka tentuar të ndërhyjë në zgjedhjet e vitit 2016 në ShBA mirëpo, sipas tij, gjatë hetimeve nuk është gjetur ndonjë e dhënë se presidenti Trump apo fushata e tij kanë bashkëpunuar me përpjekjet ruse



WASHINGTON, 18 PRILL - Prokurori i përgjithshëm amerikan, William Barr, ka sqaruar procesin e redaktimit të raportit të këshilltarit special, Robert Mueller, lidhur me ndërhyrjen ruse në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 në Shtetet e Bashkuara, duke thënë se asnjë material nuk është redaktuar në bazë të "privilegjit ekzekutiv" të presidentit amerikan Donald Trump. Barr ka thënë se hetimet e Muellerit kanë gjetur të dhëna se Rusia ka tentuar të ndërhyjë në zgjedhjet e vitit 2016 në ShBA. Mirëpo, sipas tij, gjatë hetimeve nuk është gjetur ndonjë e dhënë se presidenti Trump apo fushata e tij kanë bashkëpunuar me përpjekjet ruse. "Pas gati dy vjetëve të hetimit, mijëra thirrjeve të

detyrueshme për intervistim dhe intervistimeve të dëshmitarëve, këshilltari special ka konfirmuar se Qeveria ruse ka sponsoruar përpjekjet për të ndërhyrë ilegalisht në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016, mirëpo nuk ka gjetur se fushata e Trumpit apo amerikanë të tjerë kanë qenë pjesë e tyre", ka thënë ai.

Në reagimin e tij të parë publik pas deklaratave të prokurorit Barr, presidenti amerikan Donald Trump ka publikuar një fotografi në rrjetin social "Twitter" me mbishkrimin: "Nuk ka bashkëpunim, nuk ka ndërhyrje. Për inatxhinjtë dhe demokratët radikalë, loja ka marrë fund".

Prokurori amerikan ka thënë se raporti i Muellerit nuk paraqet

ndonjë të dhënë se Trumpi ka tentuar ta pengojë drejtësinë gjatë hetimeve për çështjen ruse. Ai i ka bërë këto komente pak para publikimit të një versioni të redaktuar të raportit të Muellerit.

Deklaratat e Barrit kanë përsëritur përfundimet që ka bërë ai në përmbledhjen e

dorëzuar para Kongresit Amerikan më 24 mars, në të cilën pati prezantuar të gjeturat kryesore të raportit të Muellerit. Megjithatë, demokratët kanë qenë të zëshëm pas dorëzimit të asaj përmbledhjeje dhe patën kërkuar publikim të plotë të raportit.

Raporti i redaktuar i prokurorit

të përgjithshëm amerikan do t'u dorëzohet zyrtarëve kongresionalë derisa do të bëhet publik për të gjithë në orën 17:00. Barr ka thënë se nuk do ta publikojë informacionin e klasifikuar dhe të dhënat për hetimet që janë duke vazhduar për shkak të privatësisë së personave të përfshirë.

## Kimi pritet ta vizitojë Rusinë gjatë këtij muaji



MOSKË, 18 PRILL - Kremlini ka njoftuar se lideri i Koresë Veriore, Kim Jong Un, planifikon ta vizitojë Rusinë brenda 12 ditëve të ardhshme. Në një deklaratë të shkurtër, të publikuar online të enjten, Kremlini ka thënë se Kim synon ta vizitojë Rusinë "në gjysmën e dytë të muajit prill", pasi ka pranuar një ftesë nga presidenti rus Vladimir Putin. Putini pritet ta vizitojë Kinën javën e ardhshme për të marrë pjesë në një forum që mbahet në Pekin më 26-27 prill, me ç'rast pritet të takohen dhjetëra krerë të shteteve në botës.

Disa organizata mediale kanë thënë se Putini mund të takohet me Kimin gjatë asaj kohe në Vladivostok, qytet në lindje të Rusisë, në afërsi me kufirin verikorean.

Njoftimi i Kremlinit vjen teksa administrata e presidentit amerikan, Donald Trump, është duke shtyrë përpara idenë e të arriturit të një marrëveshjeje për denuklearizimin e Gadishullit Korean. Të dyja samitet e mbajtura në mes të presidentit amerikan Donald Trump dhe liderit verikorean kanë dështuar që të arrijnë rezultat.

Administrata e Trumpit ka përmendur mundësinë e organizimit të një samiti të tretë, mirëpo Koreja Veriore ka kërkuar më 18 prill nga Uashingtoni që ta largojë Sekretarin amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, nga zhvillimi i negociatave në të ardhmen.

Përfaqësuesi i posaçëm amerikan për Korenë Veriore, Stephen Biegun, pritej që më 17 dhe 18 prill të takohet me zyrtarët rusë për ta diskutuar paraprakisht "denuklearizimin e plotë të Koresë Veriore", ka thënë Uashingtoni zyrtar.

## Erdogani e pranon fitoren e opozitës në Stamboll

ANKARA, 18 PRILL - Debatet e periudhës elektorale kanë mbaruar, të gjithë janë kthyer në jetën e përditshme dhe të përqendruar në shtëpi dhe punë, deklaroi presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan, duke folur në Ankara

në një konferencë sindikale pas formalizimit të zgjedhjes së kandidatit si kryetar i bashkisë së Stambollit i opozitës, Ekrem Imamoglu.

Kërkesa e AKP-së për t'u rikthyer në votime për dyshime në

parregullsi të organizuara në votimin e 31 marsit është ende në pritje nga Komisioni i Lartë Elektorat, por deklarata nga presidenti Erdogan duket se tregon një pranim të rezultatit. Sipas opozitës, ekzistonte një

rrezik për presion nga ana e kreut të shtetit ndaj organit të kontrollit të votimit, përcjell Atsh. Sipas të dhënave zyrtare në fund të rinumërimit, kandidati i opozitës Imamoglu, kryesonte me 13 729 vota më



shumë ndaj ish-kryeministrit Binali Yildirim.



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN  
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

REKTORATI

|   |                  |
|---|------------------|
| Universiteti i Prizrenit<br>University of Prizren<br>Univerzitet Prizren<br>"UKSHIN HOTI" |                  |
| Pranuar me dt.  | 18.04.2019       |
| Zyra e pranimit   | Nr. i protokolit |
| 308   | 01-153           |

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: [www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)

Nr. ref. \_\_\_\_\_

Data: 18 / 04 / 2019

Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" shpall :

**KONKURS PLOTËSUES  
PËR ZGJEDHJEN E PERSONELIT AKADEMIK<sup>1</sup>**

**FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE**

Një mësimdhënës për lëndët: Sistemet e databazës (SD Sem III O); Web Dizajn (SD Sem III O); Media e re dhe multimedia (SD Sem I Z); Hyrje në web gjuhë dhe teknologji (SD Sem II O); Zhvillimi i avansuar i web-it (SD Sem IV O); Databazat e avansuara (SD Sem IV O);

Për paqartësitë ose kundërtëheniet eventuale ndërmjet konkursit në gjuhën shqipe dhe atij në gjuhën serbe, referojuni konkursit në gjuhën shqipe.

Afati i aplikimit është 15 nga data e publikimit të këtij konkursi në faqen zyrtare përkatësisht deri më datën 03.05.2019. Të dhënat tjera mbesin si në konkursin nr. 01-145 të datës 04.04.2019.

<sup>1</sup> Plotësim i konkursit nr. 01-145;



UNIVERZITET "UKSHIN HOTI" PRIZREN  
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

REKTORAT

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: [www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)

Br. ref. \_\_\_\_\_

Dana: \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

Senat Universiteta "Ukshin Hoti" objavljuje :

**Dopunski konkurs  
O IZBORU AKADEMSKOG OSOBLJA<sup>1</sup>**

**FAKULTET KOMPJUTERSKIH NAUKA**

Nastavnik predmeta: Baza podataka (SD Sem III O); Veb dizajn (SD Sem III O); Novi mediji i multimedia (SD Sem I); Uvod u veb jezik i tehnologiju (SD Sem II O); Web development (SD Sem IV O); Napredne baze podataka (SD Sem IV O);

U slučaju sporova, baza konkursa je verzija na albanskom jeziku.

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja ovog konkursa na zvaničnom sajtu, odnosno do 03.05.2019. Ostali podaci ostaju kao u konkursu br. 01-145 od 04.04.2019

<sup>1</sup> Plotësim i konkursit nr. 01-145;



E jashtëzakonshme

# Gjenden të 'varrosura' 550 monedha ari e argjendi

Disa punonjës kanë gjetur të 'varrosura' në tokë 550 monedha ari dhe argjendi në një fushë. Monedhat e shekullit të 14-t janë me vlerë 200 000 dollarë. Punonjësit gjetën monedhat gjatë gërmimeve në një fushë në



Britaninë e Madhe. Kur të shiten monedhat, ata do t'i ndajnë fitimet me pronarin e tokës.

FOTO E DITES



Një indonezian pushon mbi një elefant i cili është i shtrirë në ujë. /AFP/

E rrallë

# Princi Philip nuk heq dorë nga drejtimi i makinës

Princi Philip nuk ka hequr dorë nga drejtimi i makinës edhe pas dorëzimit të patentës. 97-vjeçari është parë sërish pas timonit të "Land



Roverit" të tij të ri. Duka i Edinburgut udhëtoi të mërkurën me makinë nëpër bazat e Kështjellës Windsor.

## BARSOLETA E DITËS



Një votues, pas votimit në Qendrën Zgjedhore nr. 4 në kryeqytet, kërkon një karrige që të ulët në korridor. Menaxheri i vendvotimit e pyet:

- Pse doni të uleni?

Votuesi:

- Që ta pres babanë që më ka vdekur para 15 vjetësh. Meqë pati votuar në zgjedhjet e kaluara, sigurisht se vjen voton edhe në këto zgjedhje.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

#### "HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World" 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.  
Regjia: Dean DeBlois



Në ora 20:00

#### "CAPTAIN MARVEL" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.  
Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck



Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)

#### "THE KID WHO WOULD BE KING",

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.  
Regjia: Joe Cornish




Regjia: Joe Cornish

Në ora 22:00

#### "U S"

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon  
Regjia: Academy Award-winning visionary Jordan Peele



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**

Sot do të ndiheni mjaft krenar për


një gjest tuajin dhe nuk do të bëni modesti tek ata persona që do t'ju përgëzojnë pa asnjë rezervë.



**DEMI**

Do të ngriheni me humor të keq sot

dhe që në orët e para të ditës ata që kanë punë me ju do ta kuptojnë që diçka nuk shkon.



**BINJAKËT**

Keni dëshirë të merrni pjesë në

shumë aktivitete dhe iniciativa sot, por edhe një ditë e plotë nuk ju mjafton.



**GAFORRJA**

Sot jeni mjaft ambicioz dhe do të

tregoni që dini të luftoni për atë çka mendoni të drejtë si dhe të merrni atë që ju takon me meritë.



**LUANI**

Jeni shumë protektivë karshi

personave të dashur sot. Mbase duhet të kuptoni që gabimet në jetë mësojnë shumë më tepër se teoritë.



**VIRGJËRESHA**

Sot nuk do të toleroni më

neglizhenca të tjera lidhur me një projekt tuajin. Jeni munduar t'i mirëkuptoni të tjerët deri më sot, por e kanë marrë si dobësi.



**PESHORJA**

Sot me durim do të arrini t'i shmangni

edhe ato situata të pakëndshme që mund t'ju shënojnë ditën. Ndjeni një frymë pesimizmi në ambientin e punës.



**AKREPI**

Edhe pse ju duket se i keni finacat e

sigurta për ca kohë nuk duhet të qëndroni në vendnumëro. Keni mundësi të ecni përpara në karrierë.



**SHIGJETARI**

Sot keni humbur në

mendime dhe nuk shihni se çfarë bëhet rreth jush. Dikush mund të përfitojë nga kjo mosvëmendje e juaja.



**BRICJAPI**

Pak pushim nga rutina do t'ju

ndihmojë të nisni përsëri me këmbën e mbarë. Do të arratiseni në një vend që ju pëlqen shumë.



**UJORI**

Dihet që sa më lart kërkon të ngjitesh aq

më të mëdha bëhen pengesat. Kjo vlen edhe për rastin tuaj, por nuk do t'ju trembë për të guxuar më shumë.



**PESHQIT**

Sot edhe një herë do të jeni ju që do të

nxirrni nga situata një person të afërt. Megjithatë të papërgatitur, do të arrini t'ia dilni në një situatë të caktuar.

## Celine Dion: Lady Gaga ka zërin më të mirë në botë



**K**ëngëtarja e hitit "My heart will go on", Celine Dion, ka shkruar një ese për Lady Gagën për revistën "Time" në lidhje


me 100 njerëzit më me influencë. "Më pëlqen Lady Gaga dhe mendoj se e ka zërin më të mirë në botë: të fuqishëm, bindës, pasionant dhe të ndjeshëm", ka shkruar ajo.

## Jennifer Lawrence i rikthehet aktrimit



**A**ktorja fituese e çmimit Oscar, Jennifer Lawrence, do t'i rikthehet aktrimit pas një pushimi të gjatë. Lawrence, që njihet për filmat me buxhet të madh si X-Men: First Class (2011) dhe the Hunger Game franchise

(2012-15), do të punojë me regjisoren teatrale Lila Neugebauer, e cila pritet ta sfidojë veten në film. Skenari i këtij filmi, që do ta rikthejë aktoren në ekran, është shkruar nga skenaristja po ashtu e re, Elizabeth Sanders.



## Beyonce publikon albumin dhe dokumentarin e ri

**K**ëngëtarja e famshme Beyonce ka njoftuar të gjithë adhuruesit se do ta publikojë albumin e saj më të ri, "Homecoming". Këngëtarja këtë e bëri me dije në

premierën e dokumentarit "Homecoming". Edhe filmi edhe albumi përfshinë pamje nga performanca e saj në skenën e Festivalit Coachella të vitit 2018.

## Hailey shkruan mesazh prekës për Justinin



**H**ailey Bieber po e ndjen dashurinë për bashkëshortin e saj, Justin Bieber. Modeluesja 22-vjeçare e ka postuar një mesazh të lezetshëm në "Instagram" dedikuar yllit 25-vjeçar të muzikës. "Dashuria ime. Ti

je një burrë i mrekullueshëm, ti më bën mua njeri më të mirë, ti më bën më të lumtur sesa që kam qenë ndonjëherë. Çmendurisht, krenare për atë që je dhe që je duke u bërë", ka shkruar Hailey te fotografia e bashkëshortit.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com

**Sport**

QENDRA SPORTIVE  
**"BUJQËSIA"**



TEL: 045 82 82 82

# Gashi: Ta harrojmë fitoren me 'Niklin', fokusi te Flamurtari

Durim Gashi ka thënë për "Epokën e re" se Ferizaj duhet ta harrojë fitoren nga Feronikeli dhe te fokusohet për ndeshjen e radhës ndaj Flamurtarit. "Ndeshja ndaj Flamurtarit do të jetë shumë e vështirë për ne, por edhe për kundërshtarin. Flamurtari ka një skuadër të mirë dhe është rivali ynë për mbijetesë, prandaj duhet ta japim maksimumin që të paraqitemi mirë dhe ta fitojmë këtë ndeshje. Tri pikë të reja do të në dërgonin edhe më afër synimeve që kemi", ka deklaruar Gashi



**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 18 PRILL - Sulmuesi i skuadrës së Ferizajt, Dren Gashi, e ka vlerësuar shumë të rëndësishme fitoren në ndeshjen e fundit ndaj Feronikelit në Drenas (1-2). Ai të enjten për "Epokën e re" ka thënë se kjo fitore duhet të harrohet sa më shpejt dhe të rikthehet fokusi te ndeshja me Flamurtarin dhe ndeshjet e tjera në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. "Synimi ynë është mbijetesë, qoftë edhe nëpërmjet barazhit. Jemi duke punuar maksimalisht për ta arritur objektivin e klubit, që është mbetja në Superligë. Fitorja me Feronikelin ka qenë shumë e rëndësishme dhe normalisht se na ka dhënë edhe

më shumë motiv për ndeshjet e radhës. Në atë ndeshje kemi pasur paraqitje të mirë, ku kemi treguar edhe karakter të fortë, por këtë fitore duhet ta harrojmë sa më shpejt dhe të fokusohemi për ndeshjet e radhës, pasi secila ndeshje ka rëndësinë e vet dhe për në të gjitha janë si finale", ka thënë Gashi.

Duke folur për ndeshjen që zhvillohet të hënën në Ferizaj, Gashi ka thënë se fitorja është obligim për skuadrën e drejtuar nga Bylbyl Sokoli, pasi është e vetmja rrugë që e dërgon drejt mbetjes në elitën e futbollit të Kosovës. "Ndeshja ndaj Flamurtarit do të jetë shumë e vështirë për ne, por edhe për kundërshtarin. Flamurtari ka një skuadër të mirë dhe është rivali

ynë për mbijetesë, prandaj duhet ta japim maksimumin që të paraqitemi mirë dhe të fitojmë këtë ndeshje. Tri pikë të reja do të në dërgonin edhe më afër synimeve që kemi", ka shtuar Gashi. Skuadra e Ferizajt nuk pati paraqitje të mira në sezonin vjeshtor dhe, përveç vonimit të përgatitjeve për sezonin pranveror, kjo skuadër bëri ndryshime edhe në shtabin teknik, ku në vend të Afrim Tovërlanit u emërua Bylbyl Sokoli. Skuadra e Ferizajt aktualisht pozicionohet në pozitën e dhjetë me 28 pikë të grumbulluara, katër pikë më shumë se Liria që është një pozitë më poshtë dhe katër pikë më pak se Flamurtari dhe Ballkani që pozicionohen në pozitë tetë dhe nëntë.

## SHKURT

### Grapci duhet të operohet

Kapiteni i KB Rahovecit, Rron Grapci, është lënduar në ndeshjen ndaj Yllit dhe tash duhet që t'i nënshtrohet një operacioni. "Pas analizave dhe skanimeve në detaje, mjekët kanë konstatuar se kapiteni Rron Grapci duhet t'i nënshtrohet një ndërhyrje kirurgjikale për ta evituar problemin në këmbë pas lëndimit që e ka pësuar në ndeshjen ndaj Yllit. Skuadra do t'i qëndrojë pranë Rronit në çdo moment deri në shërimin e plotë të tij", thuhet në njoftimin e skuadrës së Rahovecit.

### Prishtina, pa 'Plisat' në Gjilan

Skuadra e Prishtinës do të udhëtojë në Gjilan pa tifozët e vet në ndeshjen që do ta zhvillojë më 20 prill (e shtunë). Lajmi se ata nuk do të udhëtojnë në Gjilan është konfirmuar nga "Plisat". "Pas lajmërimit tonë që do të udhëtojmë në Gjilan me datën 20 (të shtunën), morëm përgjigje negative nga Policia e Kosovës, me arsyen se stadiumi në Gjilan është duke u rinovuar dhe nuk ka kushte për të dy tifozët, pasi që paraqet rrezik për masën në tribuna", thuhet në njoftim e "Plisave".

### Salihi, pjesë e stafit teknik në Kombëtaren e Shqipërisë?

Pasi mori zyrtarisht drejtimin e Kombëtares së Shqipërisë, Edy Reja po mendon edhe për stafin që do ta shoqërojë në këtë aventurë të re. Ende nuk janë zyrtarizuar emrat e bashkëpunëtorëve të tij, edhe pse flitet se zëvendëstrajner do të jetë Alessandro Calori, i cili është larguar nga drejtimi i Ternanës në Serinë C, në shkurt të këtij viti. Por, duke iu referuar asaj çfarë shkruan "Balkanweb", risia e madhe në stafin e Rejas pritet të jetë ish-sulmuesi i kombëtares shqiptare, Hamdi Salihi, i cili pak ditë më parë u tërhoq zyrtarisht nga futbollit, ndërsa është pjesë edhe stafit teknik të skuadrës me të cilën mbylli karrierën Wiener Neustadt.

### Drejtuesit e FFK-së vizitojnë Federatën e Futbollit të Maqedonisë

Drejtuesit e Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi (kryetar), Bakir Burri (nënkryetar) dhe Eroll Salihu (sekretari i përgjithshëm), kanë qëndruar të enjten për vizitë në Federatën e Futbollit të Maqedonisë, ku janë pritur nga presidenti i saj, Muamed Sejдини, sekretari gjeneral Filip Popovski dhe zëvendëssekretari gjeneral, Drilon Ganiu.

Drejtuesit e FFK-së në këtë takim uruan Muamed Sejdinin për zgjedhjen në postin e presidentit të FFM-së, ndërsa krerët e dy federatave në takim shkëmbyen përvoja në lidhje me organizimin e garave dhe ndeshjeve, investimit në infrastrukturë, si dhe shfrytëzuan këtë takim për ta dëshmuar bashkëpunimin e shkëlqyeshëm mes vete. Sipas njoftimit të FFK-së, të dy drejtuesit e federatave janë pajtuar që në të ardhmen të shtohet bashkëpunimi për zhvillimin e futbollit.

## Blerim Mula zëvendëson Ismet Munishin te Vëllaznimi

Gjakovë, 18 prill - Blerim Mula është emëruar trajner i ri i skuadrës së Vëllaznimit nga Gjakova. Trajneri Mula e ka zënë vendin e Ismet Munishit, i cili ka

dhënë dorëheqje pas humbjes së thellë në ndeshjen gjysmëfinale të Kupës nga Trepça '89 (0-4). "Pas shkëputjes së bashkëpunimit, me marrëveshje, me trajnerin Ismet

Munishi, kryesia e Klubit Vëllaznimi ka emëruar Blerim Mula udhëheqës të shtabit teknik. Mula do ta udhëheqë skuadrën deri në fund të kampi-

onatit. Bashkëpunëtorët e tij vazhdojnë të jenë ata që ishin edhe të Munishit", thuhet në njoftimin e skuadrës kuqezi nga Gjakova.





## Mbi 2 000 fëmijë sot garojnë në Festivalin Sportiv për Parafillorët e Prishtinës

PRISHTINË, 18 MAJ - Organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës, sot (e premte) do të mbahet Festivali i Parë Sportiv për Parafillorët e Komunës së Prishtinës. Festivali me moton "Premto fort, do të merrem me sport", do të mbahet në stadiumin Fadil Vokrri në Prishtinë,

duke filluar prej orës 09:15. Qëllimi i Festivalit është masivizimi i sportit dhe joshja e fëmijëve për t'u marrë me sport. Hapja dhe mbyllja e Festivalit do të jetë imitim i Lojërave Olimpikë, ndërsa fëmijët do ta kenë rastin që për herë të parë ta shpalosin talentin e tyre në futboll dhe

atletikë. Dhjetëra ekipe, meshkuj dhe femra, do të synojnë të bëhen kampionët e parë të Prishtinës në futboll, kurse dhjetëra të tillë do t'i provojnë disiplinën e atletikës si: vrapim, kërcim dhe hedhje të gjyres së imituar. Festivali mbahet në kuadër të

Ditës Ndërkombëtare të Sportit për Zhvillim dhe Paqe. Dyert e stadiumit "Fadil Vokrri" do të jenë të hapura për prindër, nxënës të tjerë dhe tifozë të ndryshëm. Në ceremoninë hapëse do të jenë të pranishëm edhe zyrtarët më të lartë të shtetit dhe Komunës së Prishtinës.



## Zhegrova, nga futbollit në rrugët e Prishtinës, në yll te Baseli

BAZEL, 18 PRILL - Edon Zhegrova ka folur për fillimin e karrierës, duke nisur nga koha kur kishte luajtur në rrugët e Prishtinës deri te transferimi në Basel. Portali "bzbasel.ch" ia ka kushtuar një shkrim të veçantë futbollistit kosovar. Pas paraqitjes së fundit, ku u zgjodh futbollisti i ndeshjes, njerëzit në Zvicër kanë nisur ta shohin me një sy ndryshe Edonin. Kjo e bën atë të buzëqesh dhe të ndihet mirë. "Është një ndjenjë thjesht fantastike. Është e përkryer. Unë e dua këtë periudhë", thotë Zhegrova në fillim të intervistës. Ai tregon se si ka nisur të luante në rrugët e Prishtinës si fëmijë, aty ku e shijonte në maksimum këtë sport, pasi futbollit për të është jetë. "Kur luan futboll në rrugë, e njeh domethënien e vërtetë të këtij sporti. E do futbollin më shumë", shton Zhegrova. "Më pëlqente të luaja në rrugë sepse isha i lirë të bëja çka të doja. Mund të bësh trike, pasime, të shënosh gola. Nuk ke çfarë t'i thuash askujt se çka duhet të bësh. Nuk ka trajnerë, nuk ka tifozë, nuk ka presion, asgjë", ka deklaruar Edoni. 20-vjeçari më pas ishte regjistruar në shkollën e futbollit të Flamurtarit, prej nga kishte kaluar tek FC Prishtina. Më tej, Zhegrova ishte transferuar në Genk, ndërsa tash 20-vjeçari është pjesë e Baselit, me të cilin debutoi nga minuta e parë fundjavën që shkoi. Atë e quajnë "Messi i Kosovës" për shkak të



shkathtësive të tij. "Edhe kur isha i ri shumë njerëz thoshin se po luaja si Lionel Messi, mirëpo unë nuk mendoj kështu. Unë jam Edon Zhegrova dhe nuk dua të luaj si dikush tjetër. Unë nuk jam Lionel Messi", ka shtuar Zhegrova. Edoni ishte lindur në Gjermani, ndërsa pas luftës familja e tij ishte kthyer në Kosovë. Ai nuk flet gjermanisht, por thotë se do të mundohet ta mësojë këtë gjuhë. "Familja ime kishte shkuar në Gjermani gjatë luftës. Më pas jemi kthyer në Kosovë. Unë nuk flas gjermanisht, por do të mundohem ta mësoj këtë gjuhë shumë shpejt", shprehet ai. Familja Zhegrova ishte kthyer në Kosovë kur Edoni ishte dy vjeç. Këtu edhe është rritur Zhegrova, ndërsa si pesëvjeçar i ishte bashkuar klubit. Edoni i kishte entuziazmuar edhe trajnerët e akademisë së Milanit, kur gjiganti italian e kishte mbajtur një kamp në Kosovë vite më parë. Pasi ai kishte nënshtrëti kosovare dhe Kosova nuk ishte e pranuar në UEFA e FIFA në atë kohë, transferimi te gjiganti italian ishte

komplikuar. Më pas, ai ishte përcjellë edhe nga PSG-ja, Arsenali e Barcelona, por ishte transferuar në Standard Liege si 15-vjeçar. Sidoqoftë, ai e ëndërron ende Barcelonën, ndeshjet e së cilës i shikon vazhdimisht dhe e admiron këtë klub. Vetëm për të shkuar në Belgjikë, Zhegrova e kishte sakrifikuar edhe familjen. "Historia se si kam shkuar në Belgjikë është e komplikuar. Merr shumë kohë për ta sqaruar. Paraprakisht, skautët e patën përcjellë një ndeshje ku i kisha shënuar 5 gola. Ata më pas absolutisht më donin mua", zbulon Edoni, familja e të cilit u transferua më pas, po ashtu, në Belgjikë. "Prindërit e mi sakrifikuan shumë për mua. Ata dëshironin që unë të kem sukses në futboll. Kjo do të ishte e vështirë të arrihej në Kosovë. Ata e donin më të mirën për mua", ka shtuar ai. "Dëshiroja të vija këtu sepse shumë lojtarë të mirë kanë luajtur këtu", thotë tutje Edoni, duke menduar për bashkëkombësit e tij, Xherdan Shaqirin dhe Granit Xhakën. "Unë jam krenar me atë që e kanë arritur ata, e krenarë me ta janë të gjithë në Kosovë", nënvizoi Zhegrova. "Ekipi kombëtar nuk është ta kërkosh një ekip më të mirë, por se për cilin vend të rrahë zemra. Mua më rrahu për Kosovën. Atje jam rritur, atje është familja ime, atje janë miqtë e mi. Unë kënaqem kur shkoj atje. Është ndjenjë fantastike kur luaj për Kosovën", përfundoi Zhegrova.

## Hardeni mposhti i vetëm Utah Jazzin, Bostoni 'fluturon' me Irvingun

HOUSTON, 18 PRILL - Houstoni udhëheq 2-0 serinë e çerekfinaleve në Konferencën e Perëndimit ndaj Utah Jazzit pas fitores 118-98 të arritur sot. Një sukses i lehtë i ekipit teksan, superior në fushë karshi Jazz në të gjithë ndeshjen, duke e merituar fitoren. James Hardeni zhvilloi një tjetër ndeshje magjike, autor i "triple double", duke realizuar 32 pikë, 13 rebounde e 10 asistime. Ndërsa tek Utah mungoi pikërisht lojtari lider. Në Lindje, skuadra e Bostonit fitoi 99-91 në fushën e tij ndaj Indianas, ndeshje ku skuadra mike shpërdoroi një avantazh prej 12 pikësh në fillimin e periodës së katërt. U mendua se Pacersi do ta fitojë ndeshjen



(Bogdanoviçi më i miri me 23 pikë), por në minutat e fundit erdhi përmbysja e Celticsit. Ai që shkëlqeu ishte Kyrie Irvingu, që realizoi 37 pikë, mbështetur edhe nga Tatum me 26 pikë. Boston udhëheq 2-0 serinë e ndeshjeve. Po 2-0 udhëheq serinë e ndeshjeve edhe ekipi i Milwaukeees, skuadra me rekordin më të mirë në sezonin e rregullt. Bucks mposhti lehtësisht 120-99 Detroitin, sfidë që u vendos

në gjysmën e dytë të saj. Milwaukee pati gjatë gjithë kohës një avantazh të lehtë, me vendësit që shpërthyen në pjesën e dytë falë 27 pikëve të Bledsoes, 26 të Antetokounmpos dhe 24 të Middletonit, një treshe që bëri diferencën në parket.

| Konferenca e Lindjes - Çerekfinale "play-off"    |        |       |
|--|--------|-------|
| 1-8 Milwaukee - Detroit                          | 120-99 | (2-0) |
| 4-5 Boston - Indiana                             | 99-91  | (2-0) |
| 3-6 Philadelphia - Brooklyn                      |        | (1-1) |
| 2-7 Toronto - Orlando                            |        | (1-1) |
| Konferenca e Perëndimit - Çerekfinale "play-off" |        |       |
| 1-8 Golden State - Clippers                      |        | (1-1) |
| 4-5 Houston - Utah Jazz                          | 118-98 | (2-0) |
| 3-6 Portland - Oklahoma                          |        | (2-0) |
| 2-7 Denver - San Antonio                         |        | (1-1) |

### SHKURT

#### Ronaldo mund të largohet nga Juventus

Ylli portugez Cristiano Ronaldo ka gjasa të largohet nga Italia qysh vitin e ardhshëm, pas zhgënjimit në Ligën e Kampionëve që pësoi Juventus këtë stinor. Gazeta italiane "Gazzetta dello Sport" të enjten ka raportuar se stinori i ardhshëm për Ronaldon mund të jetë i fundit me Juventusin. Ronaldo është jashtëzakonisht i dëshpëruar që Juventus është eliminuar në çerekfinale të Ligës së Kampionëve nga Ajaxi. Dhe ai rezultat e ka bërë të mendojë për qëndrimin në Torino. Ronaldo ka kontratë me Juventusin deri në vitin 2022, por nëse skuadra torineze nuk e fiton "Championsin" stinorin e ardhshëm, atëherë ai do të largohet.

#### Guardiola: Futbollit është i paparashikueshëm, urime Tottenhamit

Manchester City dështoi sërish në rrugëtimin për të triumfuuar në Ligën e Kampionëve, një kompeticion që po rezulton një "mollë e ndaluar" për Pep Guardiolen, që kur vendosi të largohet nga Barcelona. Në përfundim të takimit, trajneri spanjoll pranoi verdiktin e fushës, por theksoi se ka dyshime për golin e Llorentes, që rezultoi vendimtar për fatin e kualifikimit. "Është mizore, por duhet ta pranojmë. Pas 20 minutash, kryesonim 3-2 dhe në pjesën e dytë krijuam shumë raste, duke shënuar golat që na duheshin. Për fat të keq, shkoi keq për ne dhe nuk na mbetet veçse t'i urojmë fat Tottenhamit për gjysmëfinale. Jam pro VAR-it, por te goli i Llorentes kam përshtypjen se kishte një prekje me dorë", ka thënë Guardiola. Raheem Sterling shënoi golin e kualifikimit për Cityn në minutat shtesë, pro VAR-i ndërhyri për ta anuluar për pozicion jashtë loje, ndërsa Guardiola u pyet edhe për këtë moment. "E pashë aksionin dhe njerëzit më konfirmuan se ishte në pozicion jashtë loje. Ne humbëm edhe një penallti në ndeshjen e parë, por jam shumë krenar për futbollistët dhe tifozët. Kurrë nuk kam parë mbështetje të tillë që kur kam ardhur në Manchester, por futbollit është i paparashikueshëm", ka deklaruar trajneri spanjoll.

#### Nice nuk lejon largimin e Vieiras

"Patrick Vieira do të vazhdojë të qëndrojë te Nice edhe për sezonin e ardhshëm". Këto ishin fjalët e presidentit të klubit francez, Gauthier Ganaye, i cili nxitoi ta blindonte 42-vjeçarin, duke i mbyllur kështu dyert Lyonit, që është vënë në kërkim të një trajneri të ri që pas deklaratave të Bruno Genesios, i cili theksoi se do të largohet në verë. Numri një i Nices, Ganaye, e bëri të qartë se Vieira nuk do të largohet nga drejtimi i skuadrës, pasi gëzon besimin e të gjithëve dhe projekti që ata po ndërtojnë është afatgjatë. Aktualisht ekipi i drejtuar nga Vieira renditet në vendin e tetë me 48 pikë të grumbulluara.

#### Barça e Unitedi përgatiten për shkëmbimin Coutinho-Rashford

Një ide e çmendur e Barcelonës mund të sjellë në verë një nga shkëmbimet më të bujshme të merkatos në vitet e fundit. Sipas asaj që raporton "El Mundo Deportivo", Barcelona është duke shtyrë që në verë të shkëmbehen kokë me kokë Philippe Coutinhon me Marcus Rashfordin. Barcelona do ta blindojë sulmin për shumë vjet dhe me Coutinhon kjo gjë duket pamundur, pasi braziliani nuk po ngjitet në Spanjë. Kontrata e Rashordit skadon në verën e vitit 2020 dhe Barcelona është gati ta bëjë të vetin lojtarin duke ofruar Coutinhon. Unitedi nuk e sheh si një opsion të keq këtë ofertë të katalanasve, pasi braziliani e njeh shumë mirë kampionatin anglez.



|   |   |                     |   |                        |  |
|---|---|---------------------|---|------------------------|--|
| <b>Autor:<br/>GAZMEND<br/>MORINA</b>                            | SHTRESË E<br>POSHTE<br>GURËRORE E<br>MBËSHTJELL-<br>ËSIT TOKËS-<br>OR (sh.shq.) | METAFORË<br>E GJATË | SHKËMB I<br>PËRBËRË<br>PREJ RËRE<br>TË NGJESHUR<br>ME LËNDË<br>TË TJERA | OTORINOLO-<br>RINGOLOG | FUTBOLLIST<br>SPANJOLL<br>(Barcelona)<br>KADE DRURI<br>PËR VERË<br>(shq.)  |
| LLOJ BIME<br>QË KA VLERA<br>TË MËDHA<br>USHQIMORE               |   |                     |   |                        |  |
| RASA<br>AFIRMORE<br>(Gram.)                                     |   |                     |   |                        |  |
| ZËRI MË I<br>LARTË A MË I<br>HOLLË I<br>BURRIT NË TË<br>KËNDUAR |   |                     |   |                        |  |
| KUVENDI I<br>POPULLOR<br>ATHINASVE<br>ANTIK                     |   |                     |   |                        | HESHTA   |
| SHTRËNGIM<br>QË I BËHET<br>DIKUJT PËR<br>DIÇKA (shq.)           |   |                     |   |                        | BASHKËT.<br>ELEKTROK,<br>TITAN   |
| MOR, HEJ  |   |                     | RRJETË E<br>TENISIT<br>THEMELUESI<br>I TURQISË<br>MODERNE<br>MUSTAFA    |                        | FALJE FETARE<br>DITORE QË<br>BËJNË<br>MYSLIMANËT   |
| HELM I<br>DUHANIT   |   |                     |   |                        | PARAPAGIMI<br><b>EPOKA<br/>ERE</b><br>"... ISHIN<br>KATËR"<br>FORTESA<br>ALFRED<br>KAÇNARI<br>ARKA<br>SHTETËRORE<br>(Lat.) |

|               |   |   |   |  |   |   |   |   |   |
|---------------|---|---|---|--|---|---|---|---|---|
| <b>SUDOKU</b> |   |   |   |  |   |   |   |   |   |
|               |   |   |   |  |   |   |   | 3 | 1 |
|               | 2 |   | 3 |  |   |   |   | 8 |   |
|               | 5 |   |   |  | 8 |   |   |   |   |
|               | 4 | 1 | 6 |  |   |   |   |   | 5 |
|               |   | 2 | 4 |  | 5 | 6 |   |   |   |
| 8             |   |   |   |  | 9 | 7 | 2 |   |   |
|               |   |   | 9 |  |   |   | 5 |   |   |
|               | 7 |   |   |  | 1 |   | 4 |   |   |
| 6             | 8 |   |   |  |   |   |   |   |   |

|   |                               |  |   |         |                                  |  |   |   |  |  |  |                       |   |  |  |  |  |                  |  |   |
|---|-------------------------------|--|---|---------|----------------------------------|--|---|---|--|--|--|-----------------------|---|--|--|--|--|------------------|--|---|
| <b>EPOKA<br/>ERE</b>                              | KËNGËTARJA<br>JONË<br>NË FOTO | PJESËTARI I<br>NJË FISI<br>ILIR                              | KRUA<br>ARTIFICIAL KU<br>HIDHET UJI<br>PËR PJETË<br>(shq.)                                  |         | PJATË, ENË<br>(krah.)<br>TËRKUZË | ZANORE   | MUZIKANTJA<br>QARRI MUSLIU<br>HEROI<br>BOLETINI   |   |  |  |  |                       |   |  |  |  |  |                  |  |   |
| BATARE  | ○                             |  |   |         |                                  | AKTORI<br>FLLOKO<br>KEQTINGË-<br>LLIM            |   |   |  |  |  |                       |   |  |  |  |  |                  |  |   |
